**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në**

**"Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve"**

**ofruar nga**

**Universiteti Europian i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr. Ilirjan Malollari**
**Prof.Assoc. Ridvana Mediu**

**Nëntor/ 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve".**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Europian i Tiranës. |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Programi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMAS Nr. 575, datë 04.10.2022. |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë i studimeve |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike(4 semestra) |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Në fund të studimeve lëshohet Diplomë e dyfishtë. Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me një nga profilet përkatëse. |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i Shtatë në kornizën Shqiptare të Kualifikimit. |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2024-2025 13 PAE / 3 PAK<br>2023-2024 14 PAE/ 3 PAK<br>2022-2023 12 PAE/ 2 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 18 (2024-2025)<br>4 (2023-2024) |

| | | |
|---|---|---|
| | | 21 (2022-2023) |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës është licencuar për herë të parë me Urdhërin e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit Nr.575 datë 04.10.2022 për hapjen e programit të përbashkët të studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës. Në fund të këtij programi studimi lëshohet diplomë e dyfishtë.

Programi në proces të vlerësimit të jashtëm ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në Universitetin Europian të Tiranës. Fakulteti Ekonomik është licensuar me VKM Nr.255, datë 27,02,2008, i riorganizuar me Urdhër të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr.527, datë 04,09,2018.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite ECTS, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra). Në përfundim të këtij programi lëshohet diplomë Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me një nga profilet përkatëse. Programi ka si objektiv të përgatisë profesionistë dhe menaxherë të aftë për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës në drejtim të Sistemeve të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve, specifikisht Menaxhimin e Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve dhe Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore. Programi sjell një risi në organizimin e programeve të përbashkëta të studimit mes IAL-ve në Republikën e Shqipërisë.Veprimtaria akademike në programin përbashkët të studimit, të ciklit të dytë “Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve", në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, dhe Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, të Universitetit Europian të Tiranës, ka filluar në vitin akademik 2022-2023.

Bashkëpunimi për ofrimin e programit mes dy institucioneve duket se, pavarësisht qëllimit të mirë ka vend për përmirësim në drejtim të koordinimit mes tyre, për përmirësimin e kurrikulës së programit. Në urdhërin e licensimit të Ministrisë së Arsimit nr. 575, datë 04.10.2022 për programin në akreditim përcakton në pikën 3 se; *Institucionet e Arsimit të Lartë, të përmbushin rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, në lidhje me saktësimin në planin mësimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë, për laboratorët në lëndët ku parashikohet.* **Për plotesimin e këtij kushti të vendosur në licensim të programit duhet të ishin ndërrmarrë hapa konkrete, sidomos në drejtim të përmirësimit të kurrikulës dhe ofrim të praktikës së studentëve.**

*GVJ konkludon se UET **nuk i ka plotësuar plotësisht** të gjitha rekomandimet e lëna në urdhërin e licensimit.*

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve", ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

GVJ përbëhej nga Prof. Dr Ilirjan Malellari dhe Prof. Asoc. Ridvana Mediu. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatoria Teknike Msc. Rajna Lila. GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe një numër të konsiderueshëm evidencash të ndryshme, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketimit. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të proçesit mësimor, dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi një vizitë në ambientet e brendëshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit. GVJ vizitoi klasat, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj.

**Më datë 29.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 14/35 Prot., Datë 29.10.205, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 185/3 Prot, Datë 05.11.2025.**

### Përgjigje mbi "Komentet mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm"

**Programi i Studimit Master i Shkencave në: "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve"** ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, **Universiteti Europian i Tiranës.**

Grupi i Vlerësimit të jashtëm (GVJ) pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

**Standarti 1.2 Koment GVB:**

*Duke konsideruar faktin se formati i planit mësimor ka një strukturë të përcaktuar të miratuar nga MASR, nuk mund te pretendohet të ndërhyhet për të pasqyruar ndarjen e moduleve/lëndëve ndërmjet dy institucioneve përgjegjëse UET dhe UBT. Kjo problematike është diskutuar edhe gjatë vizitës së GVJ në institucionin tonë. Në këtë kontekst u evidencua se:*

1. *Ndarja e lëndëve/moduleve i referohet funksionalitetit që ato përmbajnë. Në përshtatje me funksionalitetin të lëndëve/moduleve është bërë edhe përshtatja e tyre me specifikat që ka secili institucion pjesëmarrës në këtë bashkëpunim.*

*UET angazhohet të mbuloj lëndët/modulet me karakter menaxherial gjë që është në përputhje dhe me drejtimin e departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut ndërsa institucioni bashkëpunues UBT angazhohet të zhvilloj lëndët/modulet specifike që kanë lidhje me sigurinë ushqimore për të cilat ka dhe infrastukturën përkatëse. Theksojmë se kjo është një ndarje me përshtashmërinë funksionale që është parashikuar që në fillimet e këtij bashkëpunimi*

**Përgjigje GVJ:**

Programi i studimit ofrohet si bashkëpunim midis Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës.

Programi i studimit është hapur me urdher të MASR Nr 575 Date 4.10.2022. Në pikën 3 të urdhërit të hapjes theksohet:

*"Institucionet e Arsimit të Lartë të përmbushin rekomandimet e eksperteve të jashtëm, në lidhje me saktësimin në planin mësimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë për laboratoret në orët ku parashikohet."*

Nisur nga ky fakt si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ gjykon që Departamentet Përkatëse para regjistrimit të studenteve duhet të kishin ndërrmarë hapat për reflektim të vërejtjeve të eksperteve të jashtëm. Këto ndryshime duhet të kryheshin konform procedurave që ndiqen për ndryshime në programet e licensuara por të pa akredituara. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Larte 80/2015 Neni 34 dhe neni 70, konsultim me ASCAL dokumenti "Kodi i Cilesisë).

Githashtu në Rregulloren e Përgjithshme të Programit pika 10. Hartimi, Miratimi dhe Rishikimi i Programit të Studimit dhe Rregullores së Tij, theksohet që programi mësimor rishikohet në mënyrë të vazhdueshme sipas një procedure të mirëpërcaktuar. (referencë 16. Pika 10.1-10.6)

GVJ vlerëson që këto hapa nuk janë ndërrmare dhe mendon që nuk është plotësuar kërkesa në urdherin e hapjes pika 3. Në kurrikul nuk bëhet ndarje në kredite respektive për leksione, seminare, laborator dhe detyra kursi/projekteve. Kurrikula e paraqitur (reference dok 14), nuk plotëson kriteret e VKM nr 41/2018 Shtojca1.

GVJ rekomandon rishikim të kurrikulës, rishpërndarje e krediteve në plotësim të rekomandimit në urdhërin e hapjes si dhe të Vendimit Nr 41/ date 24,01,2018 dhe vendimit Nr 282, datë 21.05.2025 “Për një ndryshim në vendimin Nr 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë; i ndryshuar”.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

***Standardi 1.3 Koment GVB:***

*Kriteri 1: Nuk ka evidenca se si realizohet kontrolli dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për pjesën e programit që nuk mbulohet në UET*

***GVB Sqarim/Koment:*** *Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në këtë bashkëpunim ka konsideruar dy dokumente kryesore dhe shumë të rëndësishme njëkohësisht:*

1. *Silabuset e lëndëve/moduleve respektive të secilit institucion*
2. *Procesverbalet e vlerësimit të studentëve.*

*Në të gjitha rastet të dy këto dokumente mbahen në dy kopje me qëllim që secili institucion i përfshirë në këtë bashkëpunim disponon kopjen përkatëse.*

**Përgjigje GVJ:**

Gvj konstaton që depozitimi i syllabuseve dhe process verbaleve të provimeve nuk është një element i mjaftueshëm kontrolli dhe bashkëpunimi për cilesinë e programit të përbashkët të ofruar. Gjate vizitës në institucion verejtjeve dhe pyetjeve lidhur me pjesën e programit të ofruar nga UBT nga përfaqesuesit e UET u theksua që secili institucion mban përgjegjësi për pjesën e programit të studimit të ofruar nga ai. Kjo është evidentuar dhe në rregulloren e perbashket të programit të studimit pika 9. UBT ofron pjesen më të madhe të programit mesimor por në dokumentin “Suplementi i Diplomës” së studentëve të diplomuar në profilin” Menaxhim i sistemeve të prodhimit të ushqimeve” lëndë të ofruara nga UBT zënë një peshë të konsiderueshme. Diploma që lëshohet është “Diplomë e Dyfishtë”, për rrjedhojë bashkëpunimi duhet të jetë më konkret si dhe format e kontrollit më efektive.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk rezultojnë të jenë ngritur mekanizma të përbashkët të vendimmarrjes si:

Bordi akademik i përbashkët i programit, apo një komitet i përbashkët i cilësisë.

Universitetet ofruese nuk kanë sisteme të njëjta vlerësimit, nuk kanë kritere të njëjta të provimeve, nuk kanë mënyra të njëjta të kontrollit të rezultateve të të nxënit. Nuk disponohet një rregullore e unifikuar për vlerësimet dhe provimet. Këto elementë janë të domosdoshëm për standartizimin e përformancës së studentit. (referencë 02 tabelat)

Në lidhje me sigurimin e cilësisë së programit

IAL ofruese nuk kanë ngritur mekanizma të përbashkëta për sigurimin e cilësisë, monitorim periodik të lëndëve apo vlerësime të stafit nga anketimi i studentëve që ndjekin programin. Nuk evidentohet nga vlerësimi i dokumentacioni hartimi i raporteve të përbashkëta vjetore apo një sistem i rregullt raportimi midis partnerëve ofrues të programit të studimit.

GVJ rekomandon ofrimin e elementëve të mësipërm si dhe ngritjen mekanizmave të përbashkët të kontrollit të kurrikulës dhe të diplomimit që sigurojnë koherencë dhe standarte të njejta akademike midis dy IAL,

(Referencë Dok 36. Rregullore e përbashkët e Programit të studimit. Pika 5. pika 9).

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

***Kriteri 3, Koment GVB:*** *Në këtë program nuk është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale. Kjo është një mangësi e programit dhe është në mospërputhje me SEM Nr 41.20J8. Për elementët e programit të studimit të ofruar nga IAL. Programi Master Shkencor.*

***GVB Sqarim/*****Koment:** Referuar VKM nr. 41/2018, në kategorinë e lëndëve plotësuese përfshihen:

"Lëndë plotësuese, të fokusuara në përftimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtesojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta të nënshkruara për këtë qëllim.

Ky formulim nuk e përcakton praktikën profesionale si një komponent të detyrueshëm, por si një mundësi që mund të realizohet përmes lëndëve që zhvillojnë aftësi të aplikueshme në tregun e punës. Gjithashtu, në Urdhrin e hapjes së programit, ekspertët nuk kanë lënë rekomandim pör shtimin e praktikës profesionale në kurrikulë, duke sjellö në konsideratë që ky element nuk është konsideruar si një mangësi edhe në fazën e miratimit të programit.

**Përgjigje. GVJ:**

Në dokumentin "Mbi Praktikën Profesionale". (referencë dokumenti 104), vendosur në dispozicion nga UBT përshkruhet konkretisht pika;

- Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme për programet me karakter profesional, programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Studenti nuk mund të diplomohet (por mund të dorëzojë diplomën) pa kryer detyrimin e praktikës.

Pra në bazën rregullative të Departamentit i jepet një rendësi e vecantë praktikës profesionale si

një element i rëndesishem i konkretizimit te njohurive te marra ne teori. Pretendimi qe nuk eshte lene apo pare si mangesi ne urdherin e hapjes se programit nuk mund te justifikoje mungesen e ketij elementi te rendesishem te programir mesimor. Sipas percaktimeve ne Ligjin 80.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH". Programet e ciklit të dytë Master i Shkencave i pergatisin studentet me njohuri te thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, neni 74,

GVJ në vlerësimin e bërë për plotësimin e standartit 1.3. Kriteri 3 si dhe në rekomandimet e lëna ka marre në konsideratë edhe komunikimin me studentët në takimin në institucion të cilët evidentuan si mangesi të programit mos zhvillimin e praktikave profesionale per studentët që ndjekin profilin "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve". Lëndët e kategorisë **D** të vendosura në kurrikulen mësimore janë konkretisht:

1. Praktika innovative të vjeljes dhe pasvjeljes, 5 kredite ECTS, 56 orë ne total nga te cilat 28 orë leksione dhe **28 orë seminare dhe praktika** (profili1) dhe
2. Menaxhim i qendrueshem i zinxhireve të vlerës ushqimore, 5 kredite ECTS, 28 ore ne total, nga te cilat **14 ore leksion dhe 14 ore seminare**, (profile 2). Lëndët mbulohen nga staf akademik I UBT (referencë tabela 12.3).

Pra lëndët e klasifikuara si lendë plotesuese të kategorise **D** nuk plotesojnë kërkesat e VKM 41/2018 Shtojca1. Lidhur me:

1. Peshën që duhet të zenë këto lendë në programin mësimor, Ato përbëjnë 8.33 % nga minimum 10 % që përcaktohet në VKM.

2. Gjithashtu në programet lëndore të tyre, syllabuset, e vëna në dispozicion (reference dokumenti 174; 185) nuk kanë element kryesor praktikën.

IAL në dokumentin" Rregullore e Praktikes" (reference dok 104) pika B 1.4.2 përcakton se:

Praktika profesionale për programet Master i Shkencave ka 12 kredite; pra një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca), 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja c raportit përfundimtar ctj).

Pra nuk është respektuar rregullorja e përcaktuar nga vetë IAL lidhur me komponentin e praktikës profesionale për studentet e ciklit të dytë Master Shkencor.

Duke vleresuar marreveshjet e bashkepunimit midis UET dhe Institucioneve apo nderrmarrjeve prodhuese të ushqimeve GVJ rekomandon shtimin e praktikes profesionale në ndërrmarjet publike apo private me të cilat institucioni ka marëveshje bashkepunimi. Ko do të kontribuonte në plotesimin e objektivave të programit të ofruar dhe Kërkesave të ligjit te Arsimit te Larte per Programet Master i Shkencave, **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**.

***Standarti II.1:***

**Konkluzione**: *GVJ konstanton se në planin mësimor nuk janë respektuar Udhëzimet e VKM Nr 41/2018 Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL, Shtojca 1. Plani mësimor nuk është paraqitur në të gjithë elementët sipas modelit të tabelë s 10. Nuk është përcaktuar ndarja e krediteve në orë leksion, seminar, laborator detyra kursi, orë pune e pavarur e studentëve. Kjo rezulton në mos përmbushje të udhëzimeve të lëna nga ekspertët dhe të reflektuara në urdhërin e VKM për hapjen e Programit të përbashkët të studimit. Pika 3. IAL ka bër kodifikimin e programit, por nuk është bërë kodifikimi i lëndëve. Programi mësimor është kryesisht i karakterit empirik. Nuk ofrohet praktike profesionale. Kryerja e praktikave në ndërrmarjet që kanë aktivitet prodhimi dhe menaxhimi të produkteve bujqesore është një domosdoshmëri për arritjen e objektivave të programit. Kryerja e Praktikave në institucione të cilat kanë aktivitet prodhimin dhe menaxhimin e produkteve bujqësore është një domosdoshmëri për arriten e objektivave të programit. Rekomandohet të vendosen në planin mësimor sidomos në profilin e lnxhinieris dhe Cilësisë së ushqimit Lëndë të këtij profili.*

**GVB Sqarim/Koment:** Në Urdherin e hapjes nr 575, datë 04.10.2022, në pikën 3 theksohet:

"Institucionet e Arsimit të Lartë të përmbushin rekomandimet e eksperteve të jashtëm, në lidhje me saktësimin në planin mësimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë për laboratorët në orët ku parashikohet."

Në vijim të këtij rekomandimi, bëjm me dije se Lëndët që ofrohen nga Universiteti Europian i Tiranës janë lëndë të karakterit menaxherial, teorike, të cilat nuk parashikojnë orë laboratorike.

Sa i përket praktikës profesionale, vlen i njëjti koment i dhënë në Kriterin 3 të Standardit 1.3, ku u sqarua se programi synon zhvillimin e aftësive praktike përmes lëndëve plotësuese, pa e bërë të domosdoshme përfshirjen e një praktike të strukturuar. Kjo qasje është në përputhje me objektivat e programit dhe me profilin e studentëve.

Është e rëndësishme të theksohet se mbi 95% e studentëve të përfshirë në këtë program janë të punësuar në kompani dhe biznese ushqimore, dhe pjesëmarrja e tyre në program është e motivuar nga nevoja për zhvillim profesional dhe kërkesa e vetë kompanive për rritjen e kapaciteteve përmes përmirësimit të njohurive teorike. Kjo tregon se programi është i orientuar drejt praktikës dhe tregut të punës, edhe pse nuk përfshin një komponent të strukturuar të praktikës profesionale.

**GVJ Përgjigje:**

GVJ në konkluzionin e arritur për plotësim të standartit II.1, "Organizimi, Drejtimi Dhe Administrimi i Programit të Ciklit të Dytë", ka vlerësuar plotësimin e të gjithë elementëve të programit të studimit të paraqitur krahasuar me udhëzimet në fuqi dhe VKM nr 41/2018. Në raport janë evidentuar qartazi mosplotësimet e kerkesave në ndarjen e lëndëve sipas kategorive ku konkretisht kemi:

**Për Profilin e dytë Menaxhim i sistemeve të prodhimit të ushqimeve Kurrikula e Programit (reference dokumenti 55), përfshin:**

Lëndë të kategorisë A =10 ECTS 8.33%,
Lëndë të kategorisë B =40 ECTS 33, 33%,
Lëndë të Kategorisë C=35 ECTS 29, 16%,
Lëndë të kategorisë D =5 ECTS 4, 16 %
Lëndë të kategorisë E =30 ECTS 25%.
Kjo ndarje nuk respekton udhëzimet e VKM Nr 41.2018 ku sipas të cilit Lëndët bazë, përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme A duhet të zënë 5-10 %, Lëndë karakterizuese, përgatitje për disiplinën shkencore B duhet të zënë 50-60 % të programit mësimor, Lëndët ndërdisiplinore integruese C duhet të jenë 12-20%, Lëndët Plotësuese duhet të zënë 10% dhe detyrimet përmbyllëse E 10-15 %.

Më lart u evidentua që edhe kërkesa e Pikes 3. Urdhër Nr 575 dt 04.10.2022, nuk është reflektuar

Arsyetimi nga ana e GVB se lendet që ofrohen nga Universiteti Europian i Tiranës janë lëndë të karakterit menaxherial, teorike, të cilat nuk parashikojnë orë laboratorike nuk justifikon faktin që në paraqitjen e programit mësimor nuk kemi një ndarje të krediteve të lendës në kredite per leksion, seminare, detyra kursi, pune individuale. Diploma e dyfishtë e lëshuar nga IAL për studentët që mbarojnë këtë program studimi (Profili 2 MSPU) së bashku me suplementin e diplomës përmban të gjithë modulet/lëndët e zhvilluar si në UET ashtu dhe në UBT.

Sipas Rregullores së Perbashket të Programit të Studimit pesha më e madhe e këtyre lëndëve mbulohet nga UBT (REFERENCE 197 Tabelat 12,3. Reference198 Plani mesimor). Për një vlerësim sa më të drejte të plotësimit të Standartit II.1 GVJ ka gjykuar që në këtë pikë ky program të shikohet në kompleks. Për programin e studimit Master i Shkencave me Sisteme të Qëndrueshtme të Menaxhimit të Ushqimeve me profilin MSPU janë vlerësuar të gjithë modulet e lëndëve që do të përfshijë suplementi i diplomës për këtë profil.

Elementi i praktikës profesionale u trajtua më siper dhe rekomandimi i GVJ është i njëjtë.

Arsyetimi nga Ana e IAL së studentët e përfshirë në program studimi janë të punësuar në kompani dhe biznese prodhuese dhe përfshirja e tyre në program është për përgatitje të thelluar teorike nuk qëndron.

***GVJ arsyeton se punësimi i studenteve nuk është një element që përjashton ose mbulon praktikën profesionale si pjesë e programit mësimor.*** Nga ana tjetër IAL në Dokumentin e praktikës profesionale, (**referencë dokumenti 104 Pika B1.5 dhe Pika B1.6**), përcaktojnë qartazi ndjekjen dhe njohjen e praktikës kur studenti është në marrëdhënie pune. Një procedurë e vlerësimit në këto raste nuk është vënë në dispozicion nga IAL.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve".**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) është institucion arsimor Privat i cili ushtron veprimtarinë e tij në Republikën e Shqipërisë me adresë, Rruga: Xhanfize Keko, Tiranë. UET është licensuar për herë të parë me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006. UET është riorganizuar me VKM Nr. 657, datë 28.09.2011. Akreditimi i fundit Institucional i është bërë më VBA Nr. 82, datë 22.09.2023[1]<br>UET përbëhet nga 5 fakultete dhe 12 Departamente, 3 qendra kërkimi dhe 32 njësi administrative. Në Vizionin e Institucionit të shprehur tek Plani Strategjik i UET 2015-2020 dhe Plani Strategjik 2021 -2025 në zhvillimin strategjik UET synon të jetë një aktor i rëndësishëm dhe institucion lider në kontributin e tij për zhvillimin social-ekonomik të vendit, në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë (pika 2- vizioni i Planit Strategjik 2015-2020); gjithë veprimtaria e UET zhvillohet në mënyrë që të përfitojë e gjithë shoqëria (pika 1- vizioni i Planit Strategjik 2021-2025). Në planin strategjik UET ka caktuar si prioritet angazhimin në edukimin e çdo studenti në mënyrë të dedikuar, duke ofruar edukim cilësor dhe duke e pajisur studentin me vlerat, aftësitë profesionale dhe disiplinën intelektuale në mënyrë që ata të ofrojnë një kontributpozitiv për shoqërinë. Programet e studimit të ofruara nga UET janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë.<br>Në përputhje me pikën 1.1 të Vizioneve Strategjike të Kërkimit |

[1] http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivaview.php?id=40591

| | |
|---|---|
| | Shkencor (2017–2020) dhe (2021–2025), UET synon të konsolidohet si qendër ekselence kërkimore me ndikim kombëtar dhe rajonal. Në këtë drejtim, institucioni ka zhvilluar bashkëpunime me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së prodhimit shkencor. Veprimtaria kërkimore e UET zhvillohet në përputhje me ligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse.<br><br>***Evidenca 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale.pdf***<br>***Evidenca 3: Plani Strategjik 2021-2025***<br>**Documentation from archive**<br>**Evidenca 1; Vendim Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti Europian i Tiranës"**<br>***Evidenca 2*: Vendim Për ndryshimin e emërtimit të Universiteti Europian i Tiranës**<br>***Evidenca 3*. Vendimi për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë Universitetit Europian të Tiranës.**<br>**Evidenca 4; Urdhër Për hapjen e programit të përbashkët të studimit, të ciklit të dytë, master i shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, cilësi dhe siguri ushqimore" dhe "Menaxhim i sistemeve të prodhimit të ushqimeve** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profilet: "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve", "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" është hartuar në bazë të misionit të UET , manualit për sigurimin e brendëshëm të cilësisë[2], Startegjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe Plani strategjik për zhvillimin e brendëshëm të programit të studimit. Programi i studimit Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve është një program i ciklit të dytë të studimeve, i cili ofrohet me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike dhe ka në total 120 ECTS. Hapja e këtij programi mbështetet në strategjinë institucionale të UET, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën ekonomike specifikisht me drejtim: Menaxhimi i Sistemeve të Prodhimit të |

| | |
|---|---|
| | Ushqimeve Programi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut pranë Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit.Zhvillohet brenda fushës së Shkencave Ekonomike dhe Agroushqimore, si pjesë e strukturës akademike të miratuar nga UET.<br>Programi trajton çështje të prodhimit të ushqimeve, menaxhimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit rural, në përputhje me misionin formues të departamentit<br><br>***Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit.pdf***<br><br>***Evidenca 30.2: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf***<br><br>***Evidenca 30.3.1 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf***<br><br>***Evidenca 30.3: Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022. Pika II: Vision, priorities, and strategic objectives.*** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi adreson drejtpërdrejt qëllimet strategjike të UET për zhvillim të qëndrueshëm, inovacion dhe ndërthurje të kërkimit shkencor me praktikat e tregut.<br>Thekson fushat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe mjedisor, të përcaktuara në Strategjinë e UET (Dokumenti Strategjik 2020–2030).<br>Promovon ndërdisiplinaritetin dhe ndërlidhjen me sektorin real, në përputhje me objektivin strategjik për përgatitje të kuadrove konkurrues në tregun e punës.<br>Statuti i UET thekson si mision të institucionit arsimimin cilësor dhe kërkimin shkencor – programi përfshin komponentë kërkimorë (tezë master) dhe module të orientuara drejt zhvillimit teorik dhe praktik.<br>Programi garanton autonomi akademike dhe cilësi mësimdhënieje, sipas kërkesave të Statutit (miratuar nga Senati Akademik i UET).<br>Programi i studimit Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është hartuar dhe ofrohet nga departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Programi ofrohet në bashkëpunim me UBT. Kurrikula që zhvillohet brenda Departamentit të Menaxhimit dhe |

| | |
|---|---|
| | Marketingut, respekton drejtimet e fushës së shkencave ekonomike dhe agrobiznesit.<br>Kurrikula nxit ndërthurjen e njohurive të marketingut, menaxhimit dhe teknologjive ushqimore, duke i dhënë programit një karakter ndërdisiplinor, siç është kërkuar në vizionin akademik të institucionit. Programi përputhet plotësisht me kuadrin strategjik të institucionit, i cili i kushton vëmëndje të veçantë gjetjes së mënyrave novatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit, dhe përtej tyre duke kontribuar në realizimin e objektivave te zhvillmit ekonomik dhe social të vendit. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve, vepron në përmbushje të misionit të institucionit për t'i pajisur studentët e programit të studimit Master në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve, me të gjitha dijet dhe njohuritë teorike dhe aplikative më bashkëkohore të sektori agroushqimor referuar në ekonomi (me fokus biznesin). Programi në akreditim ofrohet për studentë, që synojnë të përgatiten si profesionistë në fushën e sipërmarrjes së prodhimit/përpunimit të ushqimeve, hartimit të politikave afatgjata të sektorit të bujqësisë dhe ushqimit, me synim rritjen e qëndrushemërisë së sistemeve të prodhimit<br><br>***Evidenca 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale.pdf***<br>***Evidenca 7: Rregullore e programit te studimit***<br>***Evidenca*** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi është hartuar në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare si:<br>- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;<br>- Agenda 2030 e Kombeve të Bashkuara (SDGs);<br>- Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2021–2027;<br>- Strategjitë e BE-së "Green Deal" dhe "Farm to Fork".<br>Programi reflekton këto politika përmes moduleve që adresojnë zhvillimin e qëndrueshëm, prodhimin e sigurt ushqimor dhe menaxhimin mjedisor.<br><br>***Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit Master i shkencave në 'sistemet e qëndrueshme të prodhimit të Ushqimeve*** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Bazuar në analizën përshkrimore dhe dokumentacionin përkatës institucional të vënë në dispozicion nga UET, Raportin final të GVB Institucionale dhe dokumentacionin kombëtar, GVJ konstaton se programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", ofruar nga UET në bashkëpunim me UBT.*<br>*Programi është hartuar në përputhje me:*<br>*-Strategjinë institucionale të zhvillimit të UET, duke reflektuar objektivat për cilësi, kërkim dhe inovacion;*<br>*-Statutin dhe Rregulloren akademike të institucionit;*<br>*-Profilin akademik dhe strukturën e departamentit përgjegjës për pjesën e kurrikulës mësimore të ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut Fakulteti i Ekonomisë në UET (me fokus biznes);*<br>*-Dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, sigurinë ushqimore dhe politikat europiane për transformimin e sistemeve të prodhimit.*<br>*GVJ konkludon se plotësimi i objektivave dhe misionit të këtij programi studimi të vendosura nga të dy institucionet ofruese kërkon bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion për shqyrtim mungon dhe nuk është pasqyruar konkretisht mënyra e bashkëpunimit dhe si do të realizohet përmbushja e objektivave të programit në profilet Inxhinieri Cilësi dhe Siguri Ushqimore. Rregullorja e përbashkët e programit në pikën 'Modalitetet' nuk ndan qartazi detyrimet e secilit institucion në aspektin e kurrikulës mësimore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike | Institucioni (UET në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës) disponon përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete të garantuara akademike për ofrimin e programit Master në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". |

| | |
|---|---|
| specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës dhe Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm) që nga viti 2022, me urdhrin e me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.575, datë 04.10.2022 për hapjen e programit të përbashkët të studimit, të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", programi ofrohet me profilet: "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të prodhimit të Ushqimeve<br>Stafi akademik ka ekspertizë të specializuar dhe tituj të avancuar shkencorë në fushën përkatëse.<br>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin e studimit Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" përbëhet nga 15 pedagogë. Ketu jane perfshire dhe stafi nga UBT<br>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut për vitin akademik 2024-2025, ka në përbërjen e tij 7 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë (PAE), nga të cilët 1 Prof.Dr., 1 Prof.As.; 2 Dr./PhD dhe 3 Doktorante. (Lista e plotë e personelit të programit). Departamenti angazhon edhe 9 PAK. (1 Prof.Dr:;2 Prof.Asoc.Dr.;3 Dr; 3 Msc.)Total 16 staf akademik.<br>Njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësinë më të lartë në mësimdhënie.<br>Programi mbështetet në infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Institucioni ka hartuar një strategji të kërkimit shkencor.<br>Institucioni ka garantuar bashkëpunime institucionale që forcojnë praktikat profesionale dhe zhvillimin kërkimor në fushën e studimit të programit.<br>Këto elemente demonstrojnë plotësimin e kapaciteteve njerëzore, materiale dhe institucionale, duke siguruar cilësinë dhe përshtatshmërinë e programit në fushën akademike përkatëse.<br><br>***Evidencë 54.2; Urdher Nr.575 date 4.10.2022 UBT dhe UET, Për hapjen e progrmit të perbashket të studimit.***<br>***Evidencë 20; CV e stafit akademik të programit të studimit,***<br>***Evidencë 24; Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite, (Aneks tabela 6.4.)*** |

| | |
|---|---|
| | *Evidencë 02; Tabelat Permbledhese per annex, Tabela 2.1*<br><br>*Evidencë 3.1; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf*<br><br>*Evidencë 34; Marrëveshjeve të Bashkëpunimit_UET.pdf* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësive përgjegjëse – konkretisht Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut në UET dhe Fakultetetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës.<br>Fusha specifike e programit lidhet drejtpërdrejt me menaxhimin e burimeve bujqësore, prodhimin ushqimor dhe qëndrueshmërinë agro-ushqimore, duke reflektuar edhe orientimet kombëtare (sipas VKM nr. 41/2018 dhe katalogut të fushave të studimit) si dhe standardet evropiane për klasifikimin e fushave të arsimit të lartë (sipas ISCED-F 2013 – grupi 0812 dhe 0721).<br>Njëkohësisht, sipas VKM nr. 41, datë 23.01.2018, programi është i koduar me P-72MS-0788-S. Ky kodifikim reflekton përputhjen me fushën e studimit "Bujqësi dhe Teknologji Ushqimore", si dhe strukturën ligjore dhe akademike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.<br>Programi "Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me dy profile profesionale, mendojmë se duhet koduar sipas sistemit ISCED-F 2013 me kodin 0812 – Teknologji ushqimore, në përputhje të plotë me klasifikimin ndërkombëtar të fushave të arsimit të lartë.<br><br>***Evidencë 54.2 Urdher Nr.575 date 4.10.2022 UBT dhe UET, Për hapjen e programit të perbashket të studimit.***<br><br>***Evidence 20. CV e stafit akademik të programit të studimit.***<br><br>***Evidence 24: Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite, (Aneks tabela 6.4.***<br><br>***Evidencë 0.2 Tabelat Permbledhese per annex, Tabela 2.1***<br><br>***Evidencë 3.1:Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf***<br><br>***Evidencë 34: Marrëveshjeve të Bashkëpunimit_UET.pdf*** |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë | Departamenti i Menaxhimit përmbush kriterin për profilin menaxhim I sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimeve *por jo kriterin* për profilin "Inxhinieri dhe Cilësi Ushqimore", pasi nuk është një njësi me fushën akademike teknike/inxhinierike. |

| | |
|---|---|
| në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit ofrohet si bashkëpunim midis Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës. Bashkëpunimi midis IAL-ve bazohet në Marrëveshjen Kuadër nr. 477 prot., datë 01.03.2021, Marrëveshjen Specifike, nr. 477/1 prot., datë 23.09.2021 Universitetit Bujqësor të Tiranës, është institucioni përgjegjës për ofrimin e pjesës më të madhe të veprimtarisë mësimore, përfshirë lëndët/modulet dhe laboratorët. Secila palë ka përgjegjësinë e plotë për realizimin e komponentëve individual, për të cilat është përgjegjëse, sipas parashikimeve në planin mësimor.<br><br>*Komponentët e planit mësimor përgjegjës për secilën njësi nuk janë paraqitur qartësisht.*<br>Në urdhërin e licensimit të Ministrisë së Arsimit nr. 575, datë 04.10.2022 për programin në akreditim përcakton në pikën 3 se; *Institucionet e Arsimit të Lartë, të përmbushin rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, në lidhje me saktësimin në planin mësimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë, për laboratorët në lëndët ku parashikohet.* ***Për plotesimin e këtij kushti të vendosur në licensim të programit duhet të ishin ndërrmarrë hapa konkrete, sidomos në drejtim të përmirësimit të kurrikulës dhe ofrim të praktikës së studentëve.*** *GVJ konkludon se UET nuk i ka plotësuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna në urdhërin e licensimit.*<br><br>***Evidencë 7: Rregullore e programit te studimit.Pika 9. Modalitetet.*** |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | **N/A** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për | Institucioni ka në organigramë zyrën e këshillimit të karrierës së studentëve e cila funksionon sipas një rregulloreje dhe mban kontaktet me departamentët dhe studentët duke kryer dhe këshillimin e tyre. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit institucioni ofron |

| | |
|---|---|
| studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | trajnime profesionale për studentët. Institucioni organizon cdo vit Panairin e Karrierës si një mundësi për studentët të bashkërendojnë me punëdhënësit.<br><br>***Evidencë 12 : Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit***<br>***Evidencë 12.3: Poster Panairi i punës 2022-2024.*** |
| **Konkluzione** | *Programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" ofrohet në bashkëpunim nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), të cilët kanë përvojë të dokumentuar në ofrimin e programeve të ngjashme në fushat përkatëse. UET kontribuon përmes Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, ndërsa UBT përmes Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit. Të dy institucionet sigurojnë staf me tituj shkencorë dhe përvojë në kërkimin akademik, infrastrukturë të përshtatshme dhe mbështetje për studentët. Programi është ndërtuar mbi një marrëveshje kuadër dhe specifike ndërmjet UET dhe UBT, me ndarje të përgjegjësive për realizimin e planit mësimor. Megjithatë, në dokumentacionin aktual, nuk paraqiten në mënyrë të qartë dhe të detajuar ndarjet përkatëse të moduleve/lëndëve ndërmjet institucioneve, çka përbën një element për t'u përmirësuar në aspektin e transparencës dhe menaxhimit të programit.*<br>*Programi përmbush kriteret në mënyrë të konsiderueshme, me vërejtje specifike mbi nevojën për rritjen e transparencës në ndarjen e përgjegjësive midis institucioneve dhe përforcimin e përputhshmërisë së njësive bazë akademike me profilin teknik/inxhinierik të programit. Rekomandohet përmirësimi i dokumentacionit mbështetës të planit mësimor dhe reflektimi i ndarjes konkrete të moduleve në raport me kompetencat institucionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Programi Master në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është hartuar dhe zbatuar përmes një bashkëpunimi funksional ndërmjet njësive akademike dhe administrative të UET dhe UBT.<br>Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara qartë mes departamenteve, pjesë e Fakultetit Ekonomik në UET, komisioneve përkatëse dhe stafit akademik, në përputhje me rregulloren dhe strategjinë e programit. Departamentet të përfshira në mësimdhënien për programin e studimit brenda UET janë Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë Biznesit dhe Zhvillimit, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimi dhe Artet Liberale, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Programi mbikëqyret përmes strukturave të monitorimit të cilësisë dhe analizës së rregullt të performancës, duke siguruar mbarëvajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm.<br><br>Departamenti harton Raportin Vjetor.<br>Evidentohen në dokumentacion, vetëm si modele puna që bëhet për kontrollin e kurrikulave dhe planit mësimor nga NJSBC.<br>Ka evidencë mbi ngarkesën e stafit në programe të tjera të ofruara nga derpartamenti ofrues i programit të studimit. Janë paraqitur evidenca për orë të stafit akademik në programin në akreditim për departamentin e Menaxhimit në UET. (Ascal Tabela12. ). Sipas dokumentacionit ne dispozicion nga 120 Kredite ECTS Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në UET mbulon 9 lëndë (45 ECTS, afërsisht 37.5%). Pjesa tjetër e Lëndëve të përfshira në planin mësimor mbulohet nga staf akademik i UBT. *Plani mësimor nuk është paraqitur sipas modelit të tabelës 10. Nuk ka evidenca se si realizohet kontrolli dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për pjesën e programit që nuk mbulohet në UET.*<br><br>***Evidencë 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.***<br>***Evidencë 02 : Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.Tab.12.3*** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me | Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit vendor dhe ndërkombëtar, të cilat përfshijnë ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e programeve të reja të studimit. |

| | |
|---|---|
| institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Këto marrëdhënie bashkëpunimi janë kryesisht të institucionalizuara në nivel fakulteti, ku Fakulteti ka ndërmjetësuar rreth 51 marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje, institucione publike dhe organizata joqeveritare, të cilat kontribuojnë në lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimet në tregun e punës (Dokumentacioni i marrëveshjeve të bashkëpunimit),<br>Ky bashkëpunim dokumenton angazhimin e institucionit për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe rritjen e aftësive praktike të studentëve për tregun e punës.<br><br>***Evidence: 34 Marrëveshjeve të Bashkëpunimit_UET.***<br>***Evidencë 47; Faqja zyrtare e Universitetit Europian te Tiranes.***<br>***Evidencë 35: Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.***<br>***Evidencë 448; Anex 3.*** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | Megjithëse Institucioni ka bashkëpunime të shumta me institucione dhe biznese brënda dhe jashtë vendit për mbështetjen e programit Master në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile. Këto marreveshje nuk janë bëre efektive për faktin që Praktika profesionale nuk është programuar në kurrikulën e programit.<br>Departamenti ka të hartuar një dokumentacion për praktikat e studentëve por kjo nuk është konkretizuar.<br>*Në këtë program nuk është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale.*<br>*Kjo është një mangësi e programit dhe është në mospërputhje me VKM Nr 41.2018. Për elementet e programit të studimit të ofruar nga IAL. Programi Master Shkencor.*<br><br>***Evidencë 148 : Plani mësimor.***<br>***Evidencë 32,1.Dokumenti mbi praktikën profesionale.***<br>***Evidencë34:Marreveshje Bashkepunim UET*** |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion | Njësia ka hartuar raport analitik për përftime nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Raporti i hartuar i përket kryesishakt aktivitetit të Departamentit të Menaxhimit.(Programi master shkencor në administrim biznesi).Shkëmbimet e stafit akademik në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimi apo programeve Erasmus+ janë evidentuar në raport. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie |

| | |
|---|---|
| të realizimit të programit të studimit. | në Programin në akreditim nuk rezulton të jetë pjesë e këtyre shkëmbimeve.<br><br>***Evidencë 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.*** |
| **Konkluzione** | *Standardi për bashkëpunimin institucional në kuadër të programit Master në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", Institucioni ka krijuar marrëdhënie dhe marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit për ndërtimin e kapaciteteve dhe përkrahjen e procesit mësimor. Bashkëpunimet me bizneset për praktika profesionale janë të pranishme, por në këtë program nuk është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale, si lëndë e kategorisë D, në planin mësimor, gjë që kufizon plotësimin e këtij aspekti.*<br>*Institucioni ka ndërtuar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione arsimore Brënda dhe jashtë vendit. Kjo mundëson shkëmbim të stafit akademik dhe studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të | Programi i studimit ***Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve"*** zhvillohet në përputhje me |

| | |
|---|---|
| vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, neni 75, pika 3, si dhe me filozofinë dhe objektivat strategjike të UET. Ky program ofrohet me **kohë të plotë** dhe është i strukturuar në **module ose lëndë**, të vlerësuara me **kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS)**, në përputhje me standardet e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. Kohëzgjatja e studimeve për këtë program të ciklit të dytë është **dy vite akademike**, të ndara në **katër semestra**.<br><br>Në këtë program lëndët ndahen në dy tipologji:<br>Lëndë të Tipologjisë I konsiderohen lëndët me karakter kryesisht praktik/aplikativ.<br><br>Lëndë të Tipologjisë II konsiderohen lëndët me karakter kryesisht teorik.<br><br>Të gjithë lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me 5 kredite (ECTS), ndërsa punimi i diplomës është i vlerësuar me 30 kredite, duke bërë që në total ky master të ketë 120 ECTS.<br><br>GVJ konstaton se në planin mësimor nuk janë respektuar udhëzimet e VKM Nr 41.2018. Për elementët e programit mësimor të ofruara nga IAL. Shtojca 1.Plani mësimor nuk është paraqitur më të gjithë elementet sipas formatit të Tab.10. Nuk është përcaktuar ndarja krediteve në orë leksion, seminar, laborator, detyrë kursi, orë në auditor dhe orë punë e pavarur e studentëve.<br><br>*Plani është paraqitur për të dy profilet në të cilin:*<br><br>***Profili i Parë (Inxhinieri, cilësi dhe siguri Ushqimore) ka [ Lëndë A=10 ECTS 8,33%, Lëndë B =40 ECTS 33,33%, Lëndë C= 30 ECTS 25%, Lëndë D=10 ECTS 8.33% dhe Lëndë E=30 ECTS 25%.)***<br><br>***Për Profilin e dytë Menaxhim i sistemeve të prodhimit të ushqimeve eshtë bërë ndarje e krediteve ku Lëndë të kategorisë A =10 ECTS 8.33%, Lëndë të kategorisë B =40 ECTS 33,33% , Lëndë të Kategorisë C=35 ECTS 29,16%, Lëndë të kategorisë D =5 ECTS 4,16 % dhe Lëndë të kategorisë E =30 ECTS 25%.***<br><br>*Kjo ndarje nuk respekton udhëzimet e VKM Nr 41.2018 ku sipas të cilit Lëndët bazë, përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme A duhet të zënë 5-10 %, Lëndë karakterizuese ,përgatitje për disiplinën shkencore B duhet të zënë 50-60 % të* |

| | |
|---|---|
| | *programit mësimor. Lëndët ndërdisiplinore integruese C duhet të jenë 12-20%, Lëndët Plotësuese duhet të zënë 10% dhe detyrimet përmbyllëse E 10-15 %.*<br><br>Në shqyrtimin e programeve lëndore të vëna në dispozicion nga IAL GVJ konstaton se në shumicën e programeve lëndore,për lëndët e ofruara nga Departamenti i menaxhimit në UBT, janë respektuar udhëzimet e VKM Nr. 41/2018. Shtojca 2,0. Në programet lëndore të vëna në dispozicion për lëndët që jepen nga staf i UBT ka mangësi në drejtim të respektimit të udhëzimeve të VKM , konkretisht literaturë jo e 5 viteve të fundit , nuk paraqitet viti akademik, numri i krediteve, kodi i lëndës etj (lëndët, Metodologji e kërkimit shkencor, Njohuri themelore për sistemet e qëndrueshme agroushqimore, Menaxhimi i mbetjeve në industrinë agroushqimore, sistemet e gjurmueshmerisë në produktet ushqimore, zhvillimi i produkteve të reja , Zhvillimi dhe menaxhimi i sistemeve të cilësisë dhe vlerësimi i jetës të produkteve ushqimore. etj) .<br><br>Kjo rezulton në mospërmbushje dhe të udhëzimeve të lëna nga ekspertët dhe të reflektuara në Urdhrin e hapjes së programit të lëshuar nga MARS. Pika 3. Në urdhërin e licensimit të Ministrisë së Arsimit nr. 575, datë 04.10.2022 për programin në akreditim përcakton në pikën 3 se; *Institucionet e Arsimit të Lartë, të përmbushin rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, në lidhje me saktësimin në planin mësimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë, për laboratorët në lëndët ku parashikohet.*<br><br>***Evidencë 198: Plani mësimor.***<br><br>***Evidencë: 166-190 (1-18).Programet lëndore*** |
| **Kriteri 2**. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të | Programi i përbashkët i studimit, të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", ofrohet me profile: "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve". Këto dy profile të programit të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", synojnë tu mundësojnë studentëve formimin e shprehive profesionale në një spektër të gjerë specialitetesh. Bazuar në analizën e programit të studimit, ky program studimi synon t'i ofrojë studentëve të gjitha dijet dhe njohuritë aplikative më bashkëkohore të menaxhimit të sistemeve të qëndrueshme të |

| | |
|---|---|
| fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | prodhimit të ushqimeve, t'i aftësojë ata në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe cështjet e sigurisë ushqimore, të nxisë shpirtin sipërmarrës dhe të zgjerojë bashkëpiunimin dhe partneritetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes praktikave të punës, programeve të shkëmbimit studentor, pjesëmarrjes në projekte, etj.<br>Në dokumentin e strategjisë së zhvillimit të programit përcaktohet misioni, objektivat, modalitetet e zhvillimit të programit si dhe fushat e punësimit të studentëve që diplomohen. Programi Master Shkencor padyshim ka një objektiv të qartë por në vlerësimin e GVJ kurrikula e programit ka nevojë për përmirësim në mënyrë që të arrijë objektivat e vendosura dhe të mundësojë përgatitje të studentëve me njohuri të thelluara shkencore teorike dhe praktike në fushën e studimit në të dy profilet.<br>Konkretisht nga Vlerësimi i përmbajtjes aktuale të kurrikulës GVJ konstaton:<br>Bazuar në lëndët që ofron semestri I–III, programi ka një themel të fortë teorik dhe multidisiplinar për profilin "Menaxhim i Sistemeve të prodhimit të Ushqimeve" (p.sh. Qeverisja dhe Politikat, Menaxhimi i Zinxhirëve të Furnizimit, Sistemet e Gjurmueshmërisë, Marketingu i Produkteve të Qëndrueshme). Këto lëndë mbulojnë:<br>Aspektet menaxheriale dhe strategjike (Qeverisja, Politikat, Marketingu, Menaxhimi i Cilësisë).<br>Teknologjitë bazë të ushqimit (Shkenca e Ushqimit, Zhvillimi i Produkteve të Reja, Cilësia e Produkteve Shtazore).<br>Qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë mjedisore (Menaxhimi i Mbetjeve, Qëndrueshmëria Ekologjike, Etika e Ushqimit).<br>Këto lëndë përmbushin shtrirjen teorike të nevojshme për menaxherët e sistemeve ushqimore, duke iu përshtatur profilit "Menaxhim i Sistemeve të prodhimit të ushqimeve ".<br>Për profilin "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore", lëndët ekzistuese që kontribuojnë drejtpërdrejt janë:<br>Shkenca e Ushqimit dhe Teknologjitë e Përparuara (njohuri bazë laboratorike dhe teknologjike).<br>Menaxhimi i Mbetjeve të Industrisë Agroushqimore, Kimia e Mjedisit në drejtim të Prodhimit Ushqimor (qasje mjedisore-analitike).<br>Zhvillimi i Produkteve të Reja, Menaxhimi Total i Cilësisë (komponentë teknikë të cilësisë).<br>*Megjithatë, këto lëndë janë kryesisht teorike dhe konceptuale, pa një komponent të fuqishëm aplikimi teknik ose laboratorik.* |

| | |
|---|---|
| | *GVJ rekomandon të përmirësohet:*<br>1) Shtimi i Laboratorëve dhe Praktikës Aplikative<br>2) Proceset Bazë Inxhinierike (Unit Operations: transferim nxehtësie, transferim mase, filtrim, centrifugim): aktualisht mungojnë kurse që nxjerrin në pah parimet e inxhinierisë ushqimore.<br>3) Laboratorë Analitikë në cilësinë e ushqimit (mikrobiologji ushqimore, analiza kimike/detektimi të kontaminantëve).<br>4) Instrumentacion dhe Automatizim (pajisjet moderne të matjes së parametrave fizikë-kimikë gjatë përpunimit).<br>5) Integrimi i Praktikës Profesionale<br>*Duhet shtuar të paktën një modul praktik i detyrueshëm në një kompani ose laborator analitik: p.sh. 4–6 javë praktikë në një përpunues kompani prodhuese dhe përpunuese të ushqimeve si dhe në laboratorë të kontrollit të ushqimeve. Praktika në njësi të teknologjisë ushqimore për trajnim në projektimin e linjës industriale dhe monitorimin e parametrave gjatë procesit.*<br>*Detajimi i Strukturës Kurrikulare:*<br>*Duhet treguar qartë se cilat lëndë ofrohen drejtpërdrejt nga njësitë teknike (UBT – Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit) dhe cilat nga njësitë menaxheriale (UET – Departamenti i Menaxhimit).*<br>*Përcaktimi i komponentit laboratorik të çdo lënde (numri i orëve laboratorike vs. teorike) për gjurmueshmëri më të madhe.*<br><br>***Evidencë 4.0; Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit.*** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Sikurse u përshkrua më lart Programi Master i Shkencave në Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve, në kurrikulën e tij për të dy profilet nuk ofron Praktikë profesionale në kompani që merren drejtpërdrejt me prodhimin dhe përpunimin e ushqimeve. Megjithëse në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti përgjegjës për programin janë paraqitur Marrëveshje bashkëpunimi me kompani prodhuese të produkteve të ndryshme prodhuese dhe tregëtuese të ushqimeve në vendin tonë por jo vetëm (*në total Fakulteti ka nënshkruar 51 memorandume bashkëpunimi me ndërrmarrje dhe kompani),* përsëri nga këto nuk kanë përfituar drejtpërsëdrejti studentët për praktika. Në strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Misioni i programit është të integrojë njohuritë teorike me dijet aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes sa më të mirë të kërkesave të tregut gjë kjo |

| | |
|---|---|
| | që me mos vendosjen në kurrikul të praktikës profesionale cënon përgatitjen dhe aftësimin e studentëve.<br>Programi ka të përcaktuar si elementë të detyrimeve përmbyllëse mbrojtjen e diplomës për studentët që kanë shlyer të gjithë detyrimet. Diploma në programin mësimor ka 30 kredite ECTS të cilat përbëjnë 25% të gjithë krediteve të programit në kundërshtim kjo me udhëzimet e VKM Nr.41.2018,SHTOJCA 1 ku detyrimet përmbyllese përcaktohen të jenë 10-15%të tol kredite për programet Master Shkencor. Në rregulloren e programit janë përcaktuar qartë detyrimet e studentëve dhe mënyra e mbrojtjes së diplomës Master i Shkencave në Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve me profile. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe origjinal i studentit; me karakter teorik ose empirik. Në përfundim të programit lëshohet diplomë e dyfishtë.<br><br>***Evidencë 198: Plani mësimor.*** |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **NA** |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. | **NA** |

| | |
|---|---|
| Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | UET-i është një institucion jo-publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Kurse financimi bazohet kryesisht nga të ardhurat e tarifave të studimit dhe projektet ku UET është i përfshirë.<br><br>***Evidencë 2:2. Statuti UET_struktura organizative aktuale.*** |
| **Kriteri 7**. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Analiza programeve të ngjashme të ofruara nga IAL të tjera në vendin tonë tregon se ≥70 % e përmbajtjes së këtij Masteri përkojnë me përmbajtjet e programeve homologe, duke respektuar detyrimin ligjor për përputhshmëri minimale (Neni 86, Ligji 80/2015). Kurse si "Teknologji Ushqimore", "Menaxhim i Cilësisë", "Kontroll Mikrobiologjik" dhe "Menaxhim Zinxhirësh" gjenden në të paktën tri programe të tjera Master që përdorin ISCED-F 0812 (p.sh. "Teknologji Agroushqimore" dhe "Bioteknologji Ushqimore" në UBT). |
| **Kriteri 8**. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Në zbatim të direktivave të Institucioneve kompetente, për programin e ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" UET ka propozuar kodin P-72MS- 0788-S, me argumentimin: bazuar në kurrikulën dhe rezultatet e të nxënit të tij, fusha e programit të studimit sipas ISCED-F 2013: Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë inxhinieri, prodhim dhe ndërtim. Programi është ndërdisiplinor, ndërthurrje e fushave Teknologji ushqimore dhe Menaxhim. Në planin mësimor të vënë në dispozicion nuk është kryer kodifikimi i lëndëve . |

| | |
|---|---|
| | ***Evidencë 14: Kurrikula e programit MSH Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve.pdf***<br><br>***Evidencë 198: Plani mësimor*** |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është një program i përbashkët midis Universitetit Europian të Tiranës dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, institucion publik i arsimit të lartë. Zbatimi i këtij programi të përbashkët realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Programi ka nisur veprimtarinë në bazë të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 575, datë 04.10.2022, për hapjen e programit të përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomë të dyfishtë, të lëshuar nga të dy institucionet pjesëmarrëse. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në planin mësimor nuk janë respektuar udhëzimet e VKM Nr 41.2018. Për elementët e programit mësimor të ofruara nga IAL. Shtojca 1.Plani mësimor nuk është paraqitur me të gjithë elementet sipas formatit të Tab.10. Nuk është përcaktuar ndarja krediteve në orë leksion, seminar, laborator, detyrë kursi, orë në auditor dhe orë punë e pavarur e studentëve. Kjo rezulton në mospërmbushje dhe të udhëzimeve të lëna nga ekspertët dhe të reflektuara në Urdhrin e hapjes së programit të lëshuar nga MARS. Pika 3. IAL ka bëre kodifikim të programit mësimor sipas udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi, nuk është bërë kodifikimi i lëndëve. Plani mësimor është kryesisht i karakterit teorik empirik. Nuk ofrohet Praktikë profesionale. Kryerja e Praktikave në institucione të cilat kanë aktivitet prodhimn dhe menaxhimin e produkteve bujqësor është një domosdoshmëri për arritjen e objektivave të programit. Rekomandohet të vendosen në planin mësimor sidomos në profilin e Inxhinierisë dhe Cilësisë së ushqimit lëndë të këtij profili.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Standardi II.2** |
|---|

<table>
<tr><th colspan="2">Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</td><td>Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i cili përmbush në mënyrë të plotë kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik të një programi të ciklit të dytë.<br>Fakulteti përbëhet nga tre struktura akademike:<ul><li>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut,</li><li>Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës,</li><li>Qëndra për Zhvillimin e Qëndrueshëm.</li></ul>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në vitin akademik 2024-2025 është i përbërë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (7 pedagogë PAE) dhe 9 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:
<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit<br><br>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut</th><th colspan="2">Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit<br><br>(viti 2024-2025)</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof.Asoc</td><td>1</td><td>2</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>2</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Dr. Proc</td><td>3</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>-</td><td>3</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Gjithsej</td><td>7</td><td>9</td></tr>
<tr><td colspan="2">16 totali</td></tr>
</table>
Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin dhe menaxhimin e programit është Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili përmban dy grup-lëndë: Menaxhim dhe Marketing. Departamenti mbulon funksionet e planifikimit, zhvillimit dhe administrimit të</td></tr>
</table>

programit, duke siguruar lidhjen mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushat përkatëse.

Përbërja e stafit akademik për vitin akademik 2024–2025 është në përputhje me VKM nr. 418, datë 10.05.2017. Departamenti ka në përbërje 7 anëtarë me kohë të plotë, përfshirë staf me tituj shkencorë (1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr.) dhe 3 Msc (doktorantë), Stafi efektiv mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit të ofruar në UET. Angazhimi i stafit të ftuar bëhet sipas planifikimit vjetor dhe me miratim institucional, duke ruajtur balancën në favor të stafit efektiv.

Bazuar në strukturën, përbërjen dhe funksionimin e njësisë përgjegjëse, institucioni përmbush plotësisht detyrimet ligjore dhe organizative për ofrimin e programit të ciklit të dytë, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, aktet nënligjore përkatëse dhe kërkesat për personel akademik dhe struktura institucionale.

***Të dhëna për Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut:***

| **Tituj/ grada** | **2022 – 2023** | | **2023 – 2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** |
| Prof.Dr. | 1 | - | 2 | - | 1 | 1 |
| Prof. Asoc. | - | 1 | 1 | 3 | 1 | 2 |
| Dr./PhD. | 5 | 6 | 5 | 2 | 2 | 3 |
| Msc. | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 |
| **Totali** | **8** | **10** | **10** | **8** | **7** | **9** |

*Plotësuar sipas tabelës 2.1 të paraqitur në tabelat përmbledhës në aneks-rvb.*

**Evidencë 02: Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.pdf**

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel | Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" nuk zhvillon praktikë profesionale. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion Njësia ofruese e programit në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren e universitetit, ka hartuar një rregullore të zhvillimit të praktikave mësimore. *Kjo nuk aplikohet për programin në* |

| | |
|---|---|
| ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | *akreditim në kurrikulën e të cilit nuk është përfshirë praktikë për lëndët që ofrohen në UET.*<br><br>***Evidencë 32,2. Mbi praktikën profesionale, pika B.1.3.1 dhe B.1 9*** |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" ka të caktuar koordinatorin e programit të studimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të institucionit. Emërimi është bërë me vendimin nr. 974, datë 27.12.2024 të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit.<br>Roli dhe përgjegjësitë e koordinatorit janë të përcaktuara qartë në aktet e brendshme të UET dhe në aneksin shoqërues të vendimit të emërimit. Koordinatori luan një rol kyç në garantimin e cilësisë akademike dhe zhvillimin e vazhdueshëm të programit përmes këtyre detyrave kryesore:<br>Kontrolli dhe vlerësimi periodik i syllabuseve të lëndëve, në përputhje me objektivat e programit dhe ndryshimet në fushën shkencore.<br>Përzgjedhja dhe përditësimi i literaturës dhe materialeve të mësimdhënies sipas zhvillimeve bashkëkohore në shkencë dhe treg. Miratimi i detyrave të kursit dhe tezave të provimit, në bashkëpunim me grupet mësimore dhe përgjegjësit e lëndëve.<br>Bashkëpunimi me qendrat dhe grupet e kërkimit, për të garantuar lidhjen mes kërkimit shkencor dhe procesit mësimor.<br>Institucioni ka strukturë të qartë dhe funksionale të koordinimit të programit, dhe roli i koordinatorit përmbush në mënyrë efektive funksionet e përcaktuara nga standardet e cilësisë në arsimin e lartë. Kjo garanton zhvillimin cilësor dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit sipas nevojave të tregut dhe të zhvillimeve shkencore.<br><br>***Evidencë 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.***<br>***Evidencë 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit Nr. Prot. 974, dt. 27.12.2024.*** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në strukturën, përbërjen dhe funksionimin e njësisë përgjegjëse, institucioni përmbush plotësisht detyrimet ligjore dhe organizative për ofrimin e programit të ciklit të dytë, në përputhje* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *me Ligjin nr. 80/2015, aktet nënligjore përkatëse dhe kërkesat për personel akademik dhe strukturë institucionale. Struktura funksionale, përbërja akademike, rregullimi i qartë i rolit të koordinatorit dhe parashikimi i procedurave të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë, e vendosin programin në një pozicion të qëndrueshëm dhe të ligjshëm për ofrimin e ciklit të dytë të studimeve. Institucioni ka krijuar kushtet e nevojshme për cilësi akademike, menaxhim efektiv dhe përmirësim të vazhdueshëm të programit, siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe standardet e Akreditimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni garanton transparencë të plotë dhe akses të lirë për të gjithë aktorët akademikë dhe administrativë në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, përfshirë programin Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve".<br>E gjithë dokumentacioni përkatës është i aksesueshëm në mënyrë të strukturuar dhe të organizuar në platformën e brendshme elektronike "Dokumentat UET". Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga UET : Statuti dhe Rregullorja e UET,<br>Rregulloret e brendshme të programeve të studimit, Planet mësimore dhe kurrikulat përkatëse, Silabuset e detajuara të çdo lënde/moduli, Aktet e tjera rregullatore dhe udhëzuese për personelin dhe studentët.<br>Personeli akademik dhe administrativ ka akses të plotë dhe të vazhdueshëm në këtë informacion, çka ndihmon në mirë organizimin e procesit mësimor dhe përcjelljen e tij në përputhje me standardet institucionale dhe kërkesat ligjore.<br>Studentët informohen rregullisht dhe në mënyrë të sistemuar për të gjithë përmbajtjen e programit dhe ecurinë e tij. Për çdo |

| | |
|---|---|
| | lëndë/modul, studentët kanë në dispozicion: Syllabuset, Objektivat mësimorë, Detyrat dhe format e vlerësimit, Bibliografinë dhe materialet ndihmëse të leximit.<br>Këto publikohen në mënyrë të rregullt edhe në sistemin LMS (Learning Management System) të institucionit, që shërben si platformë e dedikuar për ndërveprimin mes pedagogëve dhe studentëve dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së procesit mësimor.<br>Gjithashtu, informacione kyçe për programin e studimit gjenden të publikuara në faqen zyrtare të UET, në rubrikën përkatëse për programet Master, duke përmbushur standardet për informimin publik dhe komunikimin institucional me palët e interesuara.<br><br>*Gvj konkludon se :*<br>*Institucioni përmbush në mënyrë të dokumentuar dhe të strukturuar standardin për transparencën, aksesin dhe informimin mbi programin Master në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". Praktikat në zbatim sigurojnë qasje të barabartë dhe të plotë në informacion për stafin akademik, administratën dhe studentët, në përputhje me kërkesat e akreditimit dhe parimet e mirëqeverisjes institucionale.*<br><br>***Evidencë 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.***<br>***Evidence 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.***<br>***Evidence 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.***<br>***Evidence 46.3. UET LMS Guide per studentet.***<br>***Evidence 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.***<br>***Evidence 47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian te Tiranes.*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studimit përmban planin mësimor i cili përmban këto elementë, Emërtimi i PROGRAMIT, Viti akademik, semestrat, ndarje në Module të lëndëve sipas profileve, emërtimin e lëndëve, Kreditet ECTS për cdo lëndë, kategorinë e lëndës dhe ndarjen e orëve në auditor.<br>Plani mësimor nuk është paraqitur me të gjithë elementët e përshkruar në VKM Nr.41/2028 dhe sipas modelit të tabelës 10 tek aneksi Tabelat. Nuk jështë bërë ndarja e orëve në auditor dhe punë individuale dhe jashtë auditorit. Bazuar në planin 1 ECTS i takon 12 orë në auditor mësimor, Gjithashtu në hartimin dhe më vonë plani nuk ka reflektuar udhëzimet e ekspertëve të vendosura në vendimin e hapjes së Programit mësimor, pika3. Në plan nuk bëhet e ditur ngarkesa totale e orëve (punë në auditor dhe punë individuale e studentit). Ndarja e lëndëve në kredite është bërë në |

| | |
|---|---|
| | një numër të barabartë kredite për cdo lëndë, duke mos marrë parasysh kategorinë e lëndës dhe respektimin e udhëzimeve të VKM nr 41. 2018. Për elementët e programit mësimor të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. |
| **Kriteri 3**. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është i strukturuar dhe i jep studentëve informacionet e nevojshme në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Njësia Përgjegjëse për programin ka hartuar Rregulloren e programit, si dokument themelor rregullues, që parashikon qartësisht elementët e mëposhtëm:<br>Kushtet dhe kriteret e pranimit në program (pika 2 e rregullores), duke përcaktuar se aplikantët duhet të kenë përfunduar një program "Bachelor" në sistemin me kohë të plotë ose të pjesshme dhe të plotësojnë kërkesat akademike të përcaktuara në dokumentacionin përkatës.<br>Procedurat dhe kriteret për transferimin e studimeve (pika 9 e rregullores), duke garantuar një proces të qartë dhe të strukturuar për studentët që kanë ndjekur më parë një program tjetër studimi në një IAL tjetër vendase apo të huaj.<br>Procesi i ekuivalentimit të lëndëve rregullohet përmes një dokumenti specifik, i cili përcakton mënyrën e vlerësimit të përputhshmërisë së përmbajtjes së lëndëve të mëparshme me ato të programit aktual.<br>Këto elementë sigurojnë transparencë dhe standardizim në procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, duke respektuar autonominë institucionale dhe njëkohësisht duke garantuar trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët.<br>*GVJ Konkludon që;* Programi i studimit përmbush plotësisht kriterin e standardit të akreditimit që lidhet me përshkrimin e elementëve themelorë të programit: kushtet e pranimit, transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve. Rregullorja dhe dokumentacioni përkatës janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikën e mirë institucionale.<br><br>***Evidencë 02: Plani mësimor***<br>***Evidencë 14: Kurrikula e programit MSH Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve.pdf***<br>***Evidencë 7: Rregullore e programit të studimit*** |

| | |
|---|---|
| | ***Evidence 28: Dokumenti D. II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve*** <br> ***Evidencë 27, 1: Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, pika D.I.2, fq. 57-58*** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit disponon informaconet për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë. Syllabuset e lëndëve të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketimit në Programin Master i Shkencave në Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve janë të hartuara në përputhje me formatet e miratuara( referuar VKM nr 41,2018. Shtojca nr.2). Syllabuset përmbajnë informacionet e nevojshme për organizimin e secilës lëndë. Kodin, ngarkesën, vitin akademik, semestrin, objektivat, rezultatet e të nxënit, koncepte të përgjithshme, temat dhe literaturën përkatese, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit dhe Literaturën bazë dhe ndihmëse. Syllabuset janë firmosur nga titullarët e lëndëve të kategorisë Profesor dhe Përgjegjësi i Departamentit. Literatura e referuar është e 5 viteve të fundit. Ky vlerësim i takon programeve lëndore që ofrohen në UET. <br> *Për programet lëndore të lëndëve të ofruara nga UBT GVJ vlerëson që ato do të jenë subjekt i akreditimit të pjesës së programit që ofrohet nga UBT ( në vizitën Institucionale të GVJ në UET, u referua që sipas rregullores përgjegjësia e ofrimit të syllabuseve sipas formateve të miratuara është e ndarë dhe cdo institucion është përgjegjës për pjesën e programit që ofron)* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Përmbajtja e Programit të studimit Master i Shkencave i hapur për herë të parë në vitin akademik 2022 dhe që akreditohet për herë të parë nuk ka ndryshuar në këto vite. Programi aktual, pavarësish ekzistences së njësisë së sigurimit të brendëshëm të cilësisë, drejtorisë së kontrollit të kurrikulave dhe vlerësimit të kurrikulave mësimore në institucion nuk ka reflektuar ndryshimet e kërkuara në vendimin e hapjes. Komunikimi mes institucioneve arsimore ofruese të programit të përbashkët është zhvilluar kryesisht me vendosje në dispozicion të syllabusve në fillim të cdo viti akademik. (email, takimetë përbashkëta). <br> Marrëveshja e përbashkët për hapjene programit mes UET DHE UBT përcakton detyrimet e palëve dhe në aspektin e përmbajtjes së programit të studimit dhe rishikimit të tij palët shprehen ne Nenin 3 të kësaj rregullore se: Palët në kudër të shkëmbimit të përvojës akademike, do t'i dërgojnë njëra-tjetrës programet |

| | |
|---|---|
| | lëndore dhe planin mësimor për programin e përbashkët të studimit.<br><br>***Evidencë 30,2 . Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.***<br>***Evidencë 2: .Komunikime me email***<br>***Evidencë 7;Rregullore e Programit te studimit*** |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka realizuar një nivel të mirë të transparencës dhe dokumentimit të programit. Plani mësimor i programit nuk përmbush plotësisht standardin për strukturën dhe përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të VKM nr. 41/2018 dhe akteve nënligjore përkatëse. Nevojitet rishikim i planit mësimor për të përfshirë:*<br>*Rishpërndarje të krediteve për secilen kategori lënde në përputhje me VKM nr 41/2018. Shtojca1. Programi Master i Shkencave.*<br>*Rishikim në përmbushje të udhëzimeve të lëna nga ekspertët në urdhërin e hapjes së programit. Pika 3.*<br>*Ndarjen e saktë të ngarkesës në auditor dhe jashtë auditorit.*<br>*Përllogaritjen korrekte të orëve dhe krediteve sipas natyrës së lëndës.*<br>*Formatimin sipas modelit zyrtar të tabelës në aneksin e standardeve të akreditimit.*<br>*Ky rishikim është i domosdoshëm për të garantuar transparencë, përputhje me ligjin dhe cilësi akademike të programit të ofruar.*<br>*Rregullorja dhe syllabuset janë të strukturuara mirë, por bashkërendimi i përgjegjësive ndërmjet UET dhe UBT për rishikimin e përmbajtjes kërkon përmirësim. Rekomandohet rishikim i planit mësimor dhe forcim i koordinimit ndërinstitucional për garantimin e cilësisë së programit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe | Emërtimi i Programit Master i Shkencave në "Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" përputhet me fushën e studimit. Për profilin Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të |

| | |
|---|---|
| praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Ushqimeve", shpërndarja dhe kurrikula e lëndëve për këtë profil u mundëson studentëve thellim të njohurive në fushën e studimit. Mangësi e programit sikurse është vlerësuar më lart paraqet mos ofrimi i praktikave për studentët në ndërrmarje prodhuese të produkteve ushqimore dhe programi fokusohet më se shumti në aspektin teorik. Nisur nga rregullorja e përbashkët e programit të studimit si dhe nga Plani strategjik i zhvillimit të programit misioni i tij është që studentët që ndjekin programin të Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profil, paisen me të gjitha dijet dhe njohuritë teorike dhe aplikative më bashkëkohore të sektori agroushqimor referuar në ekonomi (me fokus biznesin), t'i aftësojë ata në zgjidhjen e problemeve të sektorit me të cilat ndeshen bizneset në veprimtarinë e tyre ekonomike, të nxisë mendimin e tyre krijues për një konkurencë të suksesshme të biznesit në treg. Njësia ofruese e programit ka zhvilluar politika për këshillim dhe ndjekje të studentëve pas mbarimit të studimeve në lidhje me punësimin e tyre.<br>Përsa i përket profilit "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore; në përputhje me analizën e përmbajtjes së programit dhe krahasimin me standardet profesionale dhe akademike për programet me profil "inxhinierik", vlerësojmë se komponenti "Inxhinieri" në profilin aktual nuk përfaqësohet në mënyrë të plotë në kurrikulë.<br><br>*Për rrjedhojë, rekomandohet:*<br>*a) shtimi i moduleve me përmbajtje të mirëfilltë inxhinierike si psh: inxhinieria e proceseve në industrinë ushqimore,projektimi dhe menaxhimi i linjave të përpunimit ushqimeve,instrumentacioni dhe automatizimi në industrinë ushqimore ( nëse UBT si institucion partner mund të ofrojë në infrastrukturë)*<br>*b) ose rishikimi i emërtimit të profilit në funksion të përmbajtjes aktuale, për të shmangur keqkuptimet dhe për të ruajtur saktësinë akademike e profesionale.*<br><br>***Evidencë 7: Rregullore e programit te studimit.pdf*** |
| **Kriteri 2**. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore | Programi në tërësi reflekton një qasje të ndërthurur ndërdisiplinore dhe adreson shumë prej kërkesave të VKM-së për programet "Master i Shkencave", si: Objektivat formues të |

| | |
|---|---|
| mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | përcaktuara në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të sektorit ushqimor dhe qëndrueshmërisë.<br>Lëndë që kontribuojnë në njohuritë teorike dhe praktike për sigurinë ushqimore, menaxhimin e cilësisë dhe sistemet e prodhimit të qëndrueshëm:<br>Prezencë e moduleve të natyrës kërkimore dhe zhvilluese si "Metodologjia e kërkimit shkencor", "Analiza e të dhënave dhe vendimmarrja", "Zhvillimi i produkteve të reja", dhe "Tema e diplomës". Lëndët vlerësohen me peshë të barabartë në kredite dhe orë mësimore pavarësisht tipologjisë së lëndës.<br>Vërehet një mospërputhje ndërmjet emërtimit të profilit "Inxhinieri" dhe përmbajtjes faktike të lëndëve, çka përbën një cenim të koherencës së brendshme të programit dhe kriterit 2 të Shtojcës 1 të VKM-së, që kërkon përputhje të plotë midis:<br>Titullit të programit, Përmbajtjes lëndore, Objektivave formues dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.<br><br>***Evidencë 14 : Kurrikula e Programit te studimit.*** |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Të gjitha lëndët ndjekin ndarjen 50% leksione dhe 50% seminare/laboratorë.<br>Kategoria B e cila përfshin lëndë karakterizuese të cilat fokusohen në formimin e studentit mbi fushën e studimit ka një peshë 33.33 % (referohu pershkrimit më sipër në Fushën II) duhet të rishikohet shpërndarja e krediteve në funksion të rritjes së peshës se lëndëve formuese në program kjo për të mundësuar arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve mobilitet dhe punësimin në përfundim të studimeve.<br>Tema e diplomës (30 ECTS, 25%) përfshin punë kërkimore dhe zbatim praktik, sipas standardeve të një programi shkencor.<br>Në program nuk janë paraqitur të ndara orë seminare, laboratore, apo praktika.<br>Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", është hartuar duke shfrytëzuar përvojat më të mira bashkëkohore të vendeve të huaja. Programi i studimit si dhe struktura e tij mbështetet në literaturën e huaj e cila përdoret edhe nga universitetet ndërkombëtare më të njohura, që ofrojnë programe në këtë fushë.<br><br>***Evidencë 39. Dokumenti A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika 12,2.*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Ndarja sipas veprimtarive formuese, plani është paraqitur për të dy profilet në të cilin: Profili i Parë (Inxhinieri, cilësi dhe siguri Ushqimore) ka Lëndë A=10 ECTS 8,33%, Lëndë B =40 ECTS 33,33%, Lëndë C= 30ECTS 25%, Lëndë D=10 ECTS 8.33% dhe Lëndë E=30 ECTS 25%.<br><br>Për Profilin e dytë (Menaxhim i sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve) është bërë ndarje e krediteve ku Lëndë të kategorisë A =10 ECTS 8.33%, Lëndë të kategorisë B =40 ECTS 33,33% , Lëndë të Kategorisë C=35 ECTS 29,16%, Lëndë të kategorisë D =5 ECTS 4,16 % dhe Lëndë të kategorisë E =30 ECTS 25%. Veprimtaritë formuese në programin e studimit janë ndare në raport të barabart në teori dhe praktike. Në dokumentacionin e vëne në dispozicion (plani mësimor) nuk del qartë mëyra e zhvillimit të seancave praktike dhe numri i tyre për lëndët që ofrojnë praktike laboratorike. Në lëndët e ofruar në UET nuk zhvillohen praktika.Edhe ne planet lendore te lendeve te ofruara nga UBT ndarja e ngarkeses eshte ne leksione dhe seminare,pa evidence te ngarkeses ne praktike laboratorike. Kjo konstatohet në planet mësimore të vendosura në dispozicion dhe gjithashtu në kurrikulën e planit mësimor,ku ndarja është planifikuaar në leksione dhe seminare pa përfshirë seanca laborator ose praktikë mësimore. Programi Master shkencor është një program ndërdisiplinor me kurrikul ku Lëndët fokusohen në aftësi të kërkuara nga sektori agroushqimor dhe industrisë ushqimore: cilësia, siguria ushqimore, inovacioni, gjurmueshmëria, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit. Ky program mundëson transferim të studimeve dhe mobilitet për vete fushën e gjere të studimit dhe kurrikulën qe ofron. Përfshirja e komponentëve si sipërmarrja, marketingu, ekonomia agrare forcon mundësinë e punësimit të menjëhershëm ose vetëpunësimit. Për studentët e parë që kanë mbaruar këtë program studimi nuk ka evidenca për punësim të tyre.<br><br>***Evidencë 02. Plani mësimor***<br><br>***Evidencë: 166-190 (1-18).Programet lëndore*** |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për | Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabus-eve në programin Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" përmban të gjithë elementët e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Të gjitha |

| | |
|---|---|
| marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | syllabus-et janë hartuar në përputhje me këto kërkesa, duke përfshirë pasqyrën informative, rezultatet e të nxënit, temat e detajuara, format e vlerësimit, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm, literaturën dhe vërejtjet përfundimtare të pedagogut. Literatura përfshin burime bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse, në funksion të konsolidimit të njohurive dhe zhvillimit të aftësive për kërkim dhe konsultim të pavarur të informacionit shkencor.Literatura e përdorur është e updatuar dhe e 5 viteve të fundit, për syllabuset e lëndëve të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit në UET. Departamenti I menaxhimit pranë UBT mbulon 9 lendë mësimore në kurrikulën e programit (45 krediteECTS).<br>Ky konkluzion nuk i përket programeve lëndore të ofruara nga institucioni bashkëofrues i programit UBT.<br><br>***Evidencë: 166-190 (1-18).Programet lëndore*** |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" synon t'u japë studentëve një edukim cilësor, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës.<br>Mos respektimi i ndarjes dhe peshës së kategorive formuese të programit për lëndët sipas kategorive të specifikuara nëudhëzimet dhe VKM përkatëse, mund të cënojë saktësinë e arritjes së objektivit për thellimin e njohurive në fushën përkatëse të specializimit.<br>Nëse programi nuk rishikohet për ta forcuar peshën e lëndëve të specializimit, objektivat afatgjata të programit (veçanërisht për punësim si specialistë teknikë ose kërkues) mund të realizohen pjesërisht.<br>*GVJ konkludon se Programi në përmbajtje konceptuale dhe akademike është koherent me objektivat e shpallura, por për të garantuar përputhshmëri të plotë ligjore dhe funksional si dhe për të siguruar aftësim dhe kopetenca të synuara është e nevojshme të rishikohet ndarja e krediteve për të rritur lëndët e kategorise A, B dhe D. Vetëm atëherë mund të thuhet se programi plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme mundëson arritjen e objektivave të veta.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e | Programi i studimit "Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është ndërtuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e industrisë |

| | |
|---|---|
| mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | agroushqimore, duke përgatitur studentë me aftësi të avancuara teorike dhe praktike. Përmes formimit të integruar në menaxhim, cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri ushqimore, ky program u jep studentëve një avantazh konkurrues për punësim në institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushat e politikave ushqimore, konsulencës, menaxhimit të zinxhirit të prodhimit dhe tregtimit të ushqimeve. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe rregulloren e programit, strategjine e zhvillimit të programit dhe strategjine e zhvillimit institucional, programi u mundëson gjithashtu studentëve të ndjekin ciklin e tretë të studimeve, nëse synojnë zhvillim akademik apo kërkimor.<br><br>***Evidencë 33. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët e diplomuar.*** |
| **Konkluzione** | *Programi është konceptuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe objektivat e zhvillimit të sektorit agroushqimor, me një strukturë ndërdisiplinore që mbështet zhvillimin profesional dhe kërkimor të studentëve. Ai siguron formim të integruar në menaxhim, cilësi dhe siguri ushqimore. Megjithatë, vërehen disa mospërputhje mes emërtimeve të profileve dhe përmbajtjes faktike të kurrikulës, veçanërisht për komponentin "inxhinierik". Mungon komponenti i praktikës në ndërmarrje prodhuese dhe ndarja e qartë e orëve praktike/laboratorike në syllabus. Rekomandohet rishikimi i shpërndarjes së krediteve për të rritur peshën e lëndëve formuese (A dhe B) dhe përforcimi i elementëve praktikë, në mënyrë që programi të përmbushë plotësisht objektivat e tij* formues dhe të ruajë përputhshmëri me VKM-të dhe standardet akademike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për | Departamenti është i përkushtuar për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Bazuar në Statutin UET, çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të here pas hershme |

| | |
|---|---|
| përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | me Bordin e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.<br><br>***Evidencë 12,1 Bordi i Tregut të punës; Studimi (periodik) për tregun e punës***<br>***Evidencë 12,2: Takime me Bordin e Punës.*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | UET ka forcuar mekanizmat e përfshirjes së studentëve, ALUMNI-ve dhe përfaqësuesve të tregut të punës në zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Studentët janë të përfaqësuar në **Senatin Akademik**, **Këshillin e Etikës** dhe **KSBC**, duke kontribuar në proceset vendimmarrëse.<br>Universiteti ka **fuqizuar rrjetet ALUMNI**, të cilat marrin pjesë aktive në strukturat konsultuese e projekte zhvillimore, si dhe në **Bordin e Tregut të Punës** pranë departamenteve, ku kontribuojnë ish-studentë të suksesshëm me përvojë profesionale në sektorin përkatës.<br>Gjithashtu, Departamenti organizon **mbledhje të hapura periodike me studentët**, duke mbledhur mendime e sugjerime për përmirësimin e programeve. Të gjitha veprimtaritë janë të **dokumentuara dhe të monitoruara**, duke garantuar transparencë dhe përmbushjen efektive të kriterit për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e përmirësimit të cilësisë.<br><br>***Evidencë 5. Statuti UET, Neni 29, fq.20, (Ref.Nr.2); Rregullore e UET, Kreu 4. Neni 16. fq.5 (Ref.Nr. 5) Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021 -2025. Neni 3.1; Neni 3.2. Statuti i UET, Neni 16. 18.4, 19.2.4, 19.6.2, fq. 7-9 (Ref. Nr. 2);***<br><br>***Evidencë 3.2) Plani Strategjik UET 2021***<br><br>***Evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.*** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat | Departamenti i Menaxhimit e Marketingut ka vendosur prioritetet për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Bazuar në Statutin UET, çdo program studimi, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | konsultohet në mënyrë të herë pas hershme me Bordin e Tregut të punës. Departamenti gjithashtu ka vendosur në strategjinë e zhvillimit të tij bashkëpunimin me objektivin që të përmirësojë programin.<br>Nuk ka evidenca për ndryshime në planin mësimor të iniciuara nga këto konsultime me institucione publike apo private.<br><br>***Evidencë 02: Tabelat përmbledhëse. Tabela 11.*** | | | |
| **Konkluzione** | *Departamenti është i angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit nëpërmjet konsultimeve periodike me Bordin e Tregut të Punës dhe përfaqësues të sektorit publik/privat, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UET. Studentët dhe rrjetet ALUMNI përfshihen në vendimmarrje dhe aktivitete zhvillimore. Janë organizuar mbledhje të hapura mujore me studentët dhe është dokumentuar veprimtaria përkatëse. Megjithatë, nuk ka evidenca për ndryshime të planit mësimor si rezultat i këtyre konsultimeve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" respekton standardet më të mira ndërkombëtare të kurrikulës universitare dhe është ndërtuar në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe strategjinë e zhvillimit të UET. Programi përmban objektiva të qarta, të harmonizuara me misionin, vizionin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit, siç përcaktohet në Statutin dhe rregulloren përkatëse. UET synon të ndërtojë një profil të konsoliduar kërkimor dhe mësimor, me ndikim në shoqëri dhe ekonomi përmes transferimit të dijes dhe bashkëpunimit me aktorë të jashtëm. Dokumentacioni i vënë në dispozicion pasqyron këtë qasje koherente midis objektivave të institucionit dhe përmbajtjes së programit. |

| | |
|---|---|
| | ***Evidencë 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit.*** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Fakulteti përfaqëson njësinë kryesore akademike që bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore në fusha të ndërlidhura, duke ofruar programe studimi në nivele të ndryshme që çojnë në përfitimin e diplomës. Departamenti, si njësi bazë brenda fakultetit, është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me disiplinat dhe fushat përkatëse të studimit. Ai garanton zbatimin e programeve të studimit dhe siguron bashkërendimin e veprimtarive akademike, duke respektuar lirinë akademike të stafit, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UET. Modalitetet e ngarkesës mësimore dhe kërkimore realizohen sipas rregulloreve të brendshme të institucionit.<br><br>***Evidencë 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.*** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Programi i studimit Master i Shkencave i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përfshin një fushë të gjërë të studimit. Në politikat e tij institucioni nxit përfshirjen e studentëve në trajnime dhe projekte kërkimore, me synim zhvillimin akademik dhe profesional të tyre. Konferenca e Ditëve të Studimeve Shqiptare (DSSH) është një aktivitet kyç ku studentët e ciklit të dytë prezantojnë punime shkencore, më të mirat prej të cilave publikohen në revistën "Economicus". Këto iniciativa kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në përfshirjen aktive të studentëve në kërkimin shkencor. Departamenti ka dokumentuar aktivitetin e tij në këtë drejtim.<br><br>***Evidencë 3,2: Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021 - 2025. Neni 1.2. 12,14 fq.1*** |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Aktivitetet studimore, kërkimore dhe shkencore në UET financohen nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe donacionet /financimet ngajashtë. Universiteti European i Tiranës alokon fonde në mënyrë selektive për fakultetet, në mënyrë që ato të zhvillojnë kërkimin e tyre dhe ndjek realizimin e qëllimit të tij për shndërrimin e UET në qendër ekspertize të specializuar në kërkimin shkencor që lartëson profilin kërkimor të universitetit. UET mbështetet në fondet e përfituara nëpërmjet Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve për financimin e zgjerimit |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">të kërkimit shkencor ndërdisiplinor që përputhet me qëllimet e financuesve dhe partneriteteve strategjike të UET.<br><br>***Evidencë 28.1. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta.***<br>***Evidencë 28.2 Info Link-e nga websiti i UET per marreveshje interinstitucionale dhe projekte aktive dhe te***<br>***Evidencë 28.3 Active Projects.***<br>***Evidencë 28.4 Completed projects***<br>***Evidencë 28.5. Lista e projekteve_stafi nga Departamenti i përfshirë në to 21-22. pd***</td></tr>
<tr><td>**Konkluzione**</td><td colspan="4">*Programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është ndërtuar në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe strategjinë institucionale të UET, duke reflektuar koherencë me misionin dhe objektivat e institucionit. Fakulteti dhe Departamenti garantojnë zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit në mënyrë të integruar dhe në respekt të lirisë akademike.*<br>*Institucioni nxit përfshirjen aktive të studentëve në kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional, përmes aktiviteteve të strukturuara si DSSH dhe botimeve në revistën shkencore të universitetit. Mbështetja financiare për kërkimin sigurohet nga burime të brendshme dhe të jashtme, duke mundësuar zhvillimin e projekteve kërkimore në përputhje me prioritetet institucionale dhe partneritetet strategjike.*<br>*Në tërësi, dokumentacioni i shqyrtuar dëshmon për një qasje të qëndrueshme akademike dhe kërkimore në zbatim të objektivave të programit dhe të institucionit.*</td></tr>
<tr><td rowspan="2">**Shkalla e përmbushjes së standardit**</td><td>Nuk përmbushet</td><td>**Përmbushet pjesërisht**</td><td>**Përmbushet kryesisht**</td><td>**Përmbushet plotësisht**</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>**X**</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">**Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>**Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja</td><td>Drejtimi i kërkimit shkencor i Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, është i përqendruar në Qendrën për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Infrastruktura e nevojshme, për kërkimin shkencor plotësohet edhe me asistencën praktike dhe orientuese</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | të ofruar nga strukturat mbështetëse si biblioteka, laboratoret e kompjuterëve dhe burimet njerëzore të afta përthithjen e fondeve kërkimore. Departamenti është angazhuar në 8 projekte shkencore.<br><br>***Evidencë 02. Tabelat permbledhese. Tabela 19.0*** |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Departamenti është angazhuar në kërkim shkencor dhe raporton gjithashtu botime shkencore, pjesmarrje në konferenca shkencore dhe trajnime të stafit akademik. Kërkimi shkencor mbështet financiarisht dhe nxitet nga Institucioni nëpërmjet hartimit të politikave të zhvillimit dhe pëersosjes së programeve të studimit. Në projekte ongoing ose të përfunduara nuk janë përfshirë studentë sipas raportimit në dokumentacionin tabelat. Kërkimi shkencor i studentëve nxitet nëpermjet detzrave dhe projekteve shkencoreper tema te caktuara dhe si pjese e vleresimit të tyre. Gjithashtu studentët në punimin e diplomës i cili sipas rregullores se departamentit duhet të jetë një punim i mirëfilltë shkencor studentët asistohen nga stafi akademik. Departamenti bashkëpunon me njësitë e tjera ndihmëse në funksion të realizimit të objektivave për kryerjen e kërkimit shkencor.<br><br>***Evidencë 02. Tabelat permbledhese. Tabela 20.0***<br>**Evidencë 02. Tabelat permbledhese tab19.tabela20.** |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | Me qëllim mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve në përmbushjen e objektivave akademike dhe kërkimore, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit organizon çdo fillim viti akademik aktivitetin "DSSH Junior", një herë në vit zhvillohet Konferenca "Ditët e Studimeve Shqiptare", me pjesëmarrje të stafit dhe studentëve.<br>Fakulteti boton edhe revistën shkencore me akses të hapur "Economicus", e cila përmbush standardet ndërkombëtare dhe shërben si platformë për publikime origjinale në gjuhën angleze.<br><br>***Evidencë 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2020-2025.pdf***<br><br>***Evidencë 55.1. Ditët e Studimeve Shqiptare Junior (DSSH)_2021-2024.pdf55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf***<br><br>***Evidencë 55.2. Kalendari i aktiviteteve 2022-2023.pdf*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Programi e realizon këtë kriter përmes një kurrikule bashkëkohore të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, bashkëpunimit me aktorë të tregut të punës dhe angazhimit të studentëve në kërkim shkencor e projekte zhvillimore. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Në përfundim të programit të studimit Studentët paisen me Diplomë dhe suplementin e diplomës. Modeli i diplomës dhe suplementi janë paraqitur në dokumentacion. Studenti në mbarim të këtij cikli studimesh nuk paiset me Licence profesioni.<br><br>***Evidencë 15. Modeli i Diplomes.pdf***<br><br>***Evidencë 15.1. Suplementi i diplomes.pdf*** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Ky program studimi nuk nxjerr specialistë që janë subjekt i ligjit për profesionet e rregulluara. Programi i pais studentët me Diplomën përkatëse: Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve". |
| **Konkluzione** | *Programi "Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" mbështet kërkimin shkencor përmes Qendrës për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe strukturave ndihmëse (bibliotekë, laboratorë, staf i kualifikuar). Departamenti është angazhuar në 8 projekte kërkimore dhe nxit pjesëmarrjen e stafit në botime e konferenca.*<br>*Studentët përfshihen në kërkim përmes projekteve mësimore dhe tezës shkencore, me asistencën e stafit akademik. Fakulteti organizon konferenca vjetore dhe boton revistën "Economicus" me standarde ndërkombëtare.*<br>*Programi ofron një kurrikulë bashkëkohore dhe lidhje me tregun e punës. Studentët diplomohen me titullin "Master i Shkencave", pa licencë profesionale, pasi drejtimi nuk lidhet me profesione të rregulluara.* |

| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Programi i studimit zbaton forma të qarta dhe të strukturuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të përcaktuara në Rregulloren e UET dhe në planin mësimor përkatës. Leksionet dhe seminaret zhvillohen për 14 javë në çdo semestër, ndërsa në javën e 13-të parashikohet dorëzimi i detyrave të kursit apo eseve.<br>Procesi i mësimdhënies është i kombinuar me vlerësim të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit, duke i dhënë mundësi studentëve të adresojnë mangësitë në kohë. Gjithashtu, përmes bashkëpunimit me tregun e punës, janë organizuar leksione të hapura me ekspertë të fushës, duke përforcuar lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës. Këto forma kontribuojnë në përmbushjen efektive të objektivave të programit.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore UET.*** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke | Departameti i Menaxhimit dhe Marketingut ofrues i Programit Master Shkencor në "Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", ka paraqitur në dokumentacioni e ngarkuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve të ofruara nga ky departamet. |

| | |
|---|---|
| ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Syllabuset përmbajnë metodologjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, literaturën bazë dhe të rekomanduar, format alternative të vlerësimit dhe trajtimit të përmbajtjes.Plani mësimor – Parashikon lëndët, numrin e javëve, format formuese si leksione, seminare.<br>Në dokumentacionin e veprimtarive akademike nuk evidentohet përdorimi i metodave si diskutimet në grup, analiza rastesh dhe përfshirja e ekspertëve të ftuar në auditore.<br>Në dokumentacion është vendosur raporti për përpuethshmërinë e syllabuseve si model bosh<br>Raportet e zhvillimit të lëndëve dhe procesverbale të takimeve akademike – Tregojnë fleksibilitetin metodik dhe përshtatjen ndaj nevojave të studentëve<br>Pasi personeli akademik ofron metoda të larmishme mësimdhënieje e mësimnxënieje, të specifikuara në syllabus, duke përdorur mjete bashkëkohore dhe forma alternative si analiza rastesh, punë në grup, diskutime kritike dhe leksione me ekspertë të fushës, në përgjigje të nevojave dhe diversitetit të studentëve.<br><br>***Evidencë 198: Plani mesimor***<br>***Evidencë 166-190: Programet lëndore.***<br>***Evidencë:30.15 Shpërndarja e raportit dhe ekstrakti I raportit të fokus grupeve*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Institucioni zbaton në mënyrë të qëndrueshme politika për zhvillimin profesional të stafit akademik, duke organizuar trajnime periodike dhe strukturuara mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e praktikave didaktike. Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, UET organizon rregullisht Staff Development Day dhe trajnimin "Back to Work" në fillim të vitit akademik. Vëmendje e veçantë i kushtohet trajnimit të stafit të jashtëm për njohjen me rregulloret dhe metodologjinë e mësimdhënies së Universitetit. Këto masa kontribuojnë në përputhjen e praktikave mësimore me standardet bashkëkohore dhe ndërkombëtare në arsim të lartë.<br><br>***Evidencë 11: Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.pdf***<br>***Evidencë 46.4: Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Procesi i përzgjedhjes së personelit akademik në UET kryhet në përputhje me një kuadër të qartë rregullator dhe me transparencë, ku përfshihet edhe përgjegjësi i departamentit përkatës Kriteret për rekrutim dhe vlerësim përfshijnë përvojën akademike, kualifikimet shkencore, eksperiencën profesionale jashtë auditorit dhe titujt akademikë. Këto kritere shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet nëpërmjet konkursit.<br>Në nivel të procesit mësimor, syllabuset përmbajnë rubrika të detajuara për metodologjinë e përdorur në seminare, si dhe përshkrime të qarta të aktiviteteve mësimore. Përdoren metoda interaktive në leksione dhe seminare, duke përfshirë materiale audio-vizuale, diskutime, raste studimore dhe punë në grup. Këto metoda synojnë rritjen e ndërveprimit pedagog–student dhe janë të orientuara drejt zhvillimit të aftësive të të menduarit kritik.<br>Gjithashtu, përmes literaturës së rekomanduar dhe artikujve për studim të pavarur, studentët inkurajohen të ushtrojnë autonomi në të nxënë. Detyrat e kursit në formatin e prezantimeve në grup, kontribuojnë në kultivimin e aftësive bashkëpunuese dhe përforcojnë procesin e të nxënit përmes shkëmbimit të përvojave dhe analizës kritike.<br>Ky program studimi përmbush standardet për përzgjedhjen e stafit të kualifikuar akademik dhe zbaton metoda bashkëkohore të mësimdhënies, duke promovuar mendimin kritik dhe autonominë e studentëve në përputhje me praktikat e arsimit të lartë.<br><br>***Evidencë 44.2: Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme.pdf***<br><br>***Evidencë 44.1: Format dosje staf akademik me kohë të plotë.pdf***<br><br>***Evidencë 11.1: Shembull thirrje për staf akademik.pdf***<br><br>***Evidencë 39: Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.pdf***<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET.*** |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe | UET demonstron një angazhim të qëndrueshëm për përfshirjen aktive të studentëve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik. Marrja e |

| | |
|---|---|
| përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | mendimit të studentëve përmes mekanizmave të strukturuar si pyetësorët e vlerësimit, mbledhjet periodike dhe sugjerimet individuale, është pjesë integrale e kulturës institucionale të cilësisë.<br>Përveç vlerësimit të performancës së pedagogëve, angazhimi i studentëve kontribuon edhe në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe të materialeve didaktike. Mbledhjet mujore me studentët krijojnë hapësirë për reflektim të përbashkët dhe përshtatje të vazhdueshme të procesit mësimor me nevojat dhe pritshmëritë e tyre.<br>Në dokumentacionin e vënë ne dispozicion ka praktika të mbledhjes së mendimit të studentëve për programin mësimor, por nuk janë vënë në dispozicion praktikat e trajtimit të ankesave dhe sugjerimeve të studentëve, kryesisht për praktikat, vështirësinë në oraret etj<br>Programi siguron një qasje bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse në mësimdhënie, ku studentët kanë rol aktiv në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, në përputhje me parimet e menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë.<br><br>***Evidencë 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf***<br>***Evidencë 40 : G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf***<br>***Evidencë 40.1: Shembull_vlerësimi nga studentët_online.pdf***<br>***Evidencë 40.2: D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve .pdf***<br>***Evidencë 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.pdf***<br>***Evidencë 30.15: Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve.pdf*** |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me | Në UET funksionon Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), si një strukturë e përhershme dhe autonome në nivel institucional, e ngritur me vendim të Senatit Akademik dhe me propozim të Rektorit. KSBC luan një rol thelbësor në vlerësimin periodik të cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon masa për përmirësime të vazhdueshme, në përputhje me standardet europiane të |

| | |
|---|---|
| njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe me legjislacionin kombëtar në fuqi.<br>Struktura bashkëpunon aktivisht me njësitë bazë dhe realizon veprimtari të strukturuara sipas një plani të miratuar veprimi, të cilat shërbejnë për monitorimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Qëllimet strategjike të KSBC përfshijnë rritjen e cilësisë së drejtimit institucional, zbatimin e një programi akademik të harmonizuar me filozofinë e UET, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përgatitjes akademike të studentëve nëpërmjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përfshirjes së tyre në vendimmarrje.<br>Strukturat mbështetëse të UET janë të hapura ndaj zhvillimit dhe inovacionit, duke inkurajuar pedagogët në përmirësimin e praktikave të tyre dhe në eksperimentimin e formave të reja të mësimdhënies.<br><br>***Evidencë 30.1-30.13 KSBC, rregullorja F.VII.3; plani vjetor i veprimit; praktika të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies në bashkëpunim me njësitë bazë.***<br>***Evidencë 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.*** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Institucioni demonstron angazhim të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të saj, nëpërmjet planifikimit akademik, trajnimit të stafit, përfshirjes së studentëve dhe funksionimit aktiv të strukturave të brendshme të cilësisë. Praktikat e aplikuara janë në përputhje me standardet dhe filozofinë institucionale të UET.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe | Institucioni zbaton një sistem të qartë, të strukturuar dhe transparent për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve, në përputhje me Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e përgjithshme të UET. Kriteret dhe |

| | |
|---|---|
| shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | mënyrat e vlerësimit bëhen të njohura për studentët në fillim të çdo semestri përmes syllabus-it të lëndës dhe komunikimit institucional.<br>Procesi i vlerësimit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, duke integruar elementë të ndryshëm që kontribuojnë në formësimin e notës përfundimtare.<br>Ky sistem synon të masë progresin real të studentit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme (referenca: Rregullorja e programit të studimit dhe UET, 2024).<br>Përveç komponentëve të vlerësimit, studentët përfitojnë nga një sistem i kujdesit akademik dhe këshillimit të vazhdueshëm, i cili përfshin: Koordinatoren e Departamentit, e cila ndjek progresin dhe ofron mbështetje administrative dhe akademike.<br>Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila ndihmon studentët në aspektin psiko-social dhe planifikimin e karrierës Pedagogun përgjegjës për grupin, i cili ofron këshillim dhe tutorim akademik sipas një grafiku të përcaktuar nga departamenti.<br>*GVJ konstaton se: Institucioni garanton transparencë në vlerësim dhe kujdes të vazhdueshëm për studentët, duke integruar komponentë të rëndësishëm të vlerësimit të dijes dhe mbështetjes akademike, në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat bashkëkohore të arsimit të lartë.*<br><br>***Evidencë 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf*** |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Studentët informohen në mënyrë të rregullt dhe transparente mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale/shkencore, që janë të përcaktuara qartë në syllabusin e çdo lënde/moduli. Ky informacion jepet nga titullari i lëndës/modulit në fillim të ciklit mësimor dhe përditësohet sipas nevojës.<br>Përveç komunikimit gjatë orëve mësimore, studentët marrin njoftime edhe përmes platformës LMS dhe postës elektronike institucionale, ku informohen rreth: Formave të vlerësimit (provime, detyra kursi, prezantime, etj.)<br>Afateve dhe detyrimeve specifike që duhet të përmbushin<br>Sistemi i vlerësimit është i bazuar në një shkallë prej 0–100 pikësh, e cila më pas konvertohet në notë përfundimtare nga 4 në 10. Ky sistem i standardizuar dhe i komunikueshëm siguron transparencë dhe parashikueshmëri në procesin e vlerësimit, në |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri.<br>Duke pasur parasysh që programi i studimit ofron vetëm rreth 48% të programit lëndor duhet vlerësuar dhe plotësimi i këtyre standarteve nga institucioni bashkëofrues te programit të studimit.<br><br>Evidencë 7: Rregullore e programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</td><td colspan="4">Testimi dhe vlerësimi realizohet në forma të ndryshme, të përshtatura me tipologjinë e lëndës dhe rezultatet e të nxënit. Pedagogët zgjedhin mënyrën më të përshtatshme të vlerësimit sipas Rregullores, duke kombinuar elementë si detyra kursi, provime, aktivizim në seminare, etj. Kjo qasje e larmishme është vlerësuar pozitivisht nga studentët në fokus-grupe, për shkak të shpërndarjes së ngarkesës dhe vlerësimit të vazhduar. Mënyrat e testimit janë dokumentuar në legjislacionin e Institucionit dhe departamentit ofrues të programit të studimit.<br><br>Evidence 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.<br>Evidencë; 7.3 Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar_Lendet T2-T1.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Vlerësimi i studentëve në program realizohet në mënyrë të qartë, të strukturuar dhe të shumëllojshme, në përputhje me Rregulloren e UET dhe të programit të studimit. Studentët informohen paraprakisht mbi kriteret, format dhe mënyrat e vlerësimit në syllabus, në LMS dhe përmes komunikimit direkt me pedagogun. Vlerësimi bazohet në kontroll të vazhdueshëm dhe përfshin komponentë të ndryshëm si provime, detyra kursi, aktivizim në seminare të përshtatura sipas natyrës së lëndës. Kjo qasje lejon evidentimin real të kompetencave të fituara dhe vlerësohet pozitivisht nga studentët.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afateve të përcaktuara në **Kalendarin Akademik**. Si rregull, **provimet e ndërmjetme** organizohen në **javën e 7-të të semestrit** me kohëzgjatje normale, ndërsa **provimet përfundimtare** zhvillohen në fund të semestrit.<br><br>Sipas përcaktimeve të Rregullores së UET, për lëndët e tipologjisë 1, shpërndarja e komponentëve të vlerësimit përfshin: provimin e ndërmjetëm, detyrën e kursit, niveli i pjesëmarrjes dhe diskutimit në seminare apo detyrat praktike, si dhe provimin përfundimtar. Procesi i zhvillimit të provimeve realizohet me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë identitetin e studentit në fletën e provimit deri në momentin kur pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Në fillim të çdo moduli, pedagogu përkatës, gjatë prezantimit të syllabusit, informon studentët mbi afatet e parashikuara për vlerësim.<br>Sekretimi i tezave përmes sistemit elektronik të barkodeve garanton anonimitetin e studentit dhe paanshmërinë në procesin e vlerësimit.<br><br>***Evidencë. 5 – Rregullore e UET, Neni 27, fq. 8; Neni 17, fq.5***<br><br>***Evidencë. 7 – Rregullorja e Programit të Studimit "Master i Shkencave në Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"; Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.I.8.6.*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm duke rritur nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit. Që nga viti akademik 2016-2017, institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) aplikon, por jo në të gjitha lëndët, një sistem të ri vlerëslmi elektronik: "Clean Scoring" të provimeve/testimeve, si një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimit të studentëve.<br>GVJ vlerëson se Institucioni dokumenton mënyrën e vlerësimit të studentëve. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | GVJ konstaton se Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Rregulloren e UET, rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me |

| | |
|---|---|
| | profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve". |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi përfundimtar i lëndës bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, parashikuar në Rregulloren e UET dhe sanksionuar në Rregulloren e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Në bazë të natyrës së lëndës, aplikohet ndarja në Tipologji I (lëndë me përmbajtje njohurish kryesisht aplikative) dhe Tipologji II (lëndë me përmbajtje më të madhe teorike). Për lëndët e tipologjisë I, aplikohet vlerësimi i ndarë në komponentë: detyra praktike nr.1 -30%; detyra praktike nr.2 -30%; provimi final -40%. Për lëndët e tipologjisë II, aplikohet vlerësimi i ndarë në këto komponentë: aktivizimi në seminare -10%; detyra e kursit - 20% dhe provimi final - 40%.<br>Për detyrimet si punimi i diplomës është i domosdoshmëri vlerësimi me komision.<br>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrënë një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë.<br>Provimet e studentëve sekretohen dhe UET ka siguruar gjithmonë infrastrukturën e nevojshme për këtë gjë, duke i pajisur sallat e provimeve me personel të posaçëm monitorues. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me një procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.<br><br>***Evidencë Format e kontrollit te njohurive***<br>***Evidence 30.6: Format raporti per kontrollin e provimeve***<br>***Evidencë 30.7: Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet.pdf*** |

| | |
|---|---|
| | ***Evidencë 30.8: Shembull 30. Raporti për provimet Sem 1_v.a.21-22 - DEF_FEBZH.pdf***<br><br>***Evidencë 7: Rregullore e programit te studimit.*** |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për programin e studimit në akreditim GVJ konstaton se janë saksionuar qartë rregulloret e zhvillimit të provimeve. Provimet zhvillohen nën mbikëqyrjen e dy ose më shumë pedagogëve të caktuar nga Departamenti, të cilët janë njësoj përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit në sallë. Prania e personave të tjerë është e kufizuar vetëm për pedagogun e lëndës, koordinatoren për sekretimin e tezave dhe monitoruesit e autorizuar. Përdorimi i celularëve ndalohet rreptësisht. Rregullat e detajuara përcaktohen në rregulloren përkatëse. Plagjiatura dhe kopjimi janë të palejuara, në përputhje me Kodin e Etikës dhe specifikimet në syllabus.<br><br>***Evidencë 16: Kodi i etikës*** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Procesi i vlerësimit bazohet në parimin e meritokracisë, duke siguruar paanësi përmes sekretimit të tezave, ku pedagogu nuk ka dijeni mbi identitetin e studentit. Vlerësimet dorëzohen brenda afatit 2-javor nga data e provimit, ndërsa për riprovimet, afati është 1 javë për shkak të numrit më të ulët të studentëve. Të gjitha veprimet realizohen në përputhje me rregulloret përkatëse.<br><br>***Evidencë 7: Rregullore e Programit te studimit.*** |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Rregullorja e Institucionit dhe regullorja e programit të studimit parashikon hapat që duhet të ndiqen për vlerësimin, dhe kërkesat për rishikimtë vlerësimeve nga studentët. Studentët kanë të drejtë të bëjn kërkesë për rishikimin e vlersësimit të provimeve, ku petagogu i jep mundësi çdo studenti të rishikojë tezën dhe e informon në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe elementët ku ai ka gabuar.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET.*** |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të | Dokumentacioni i vënë në dispozicion paraqet bazën rregullative për shqyrtim të ankimimeve. as zhvillimit të provimit, çdo ankesë shqyrtohet fillimisht nga komisioni i vlerësimit dhe, nëse është e nevojshme, nga një komision i posaçëm me tre anëtarë, ku nuk bën pjesë pedagogu i lëndës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Ky komision vlerëson objektivisht dhe vendos për vlefshmërinë e ankesës. Për komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/praktike, provim përfundimtar), studenti ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit, pas sqarimit paraprak me pedagogun. Nuk ka një praktikë ose shembull shqyrtimi të ndonjë ankimimi të studentëve. | | | |
| **Konkluzione** | *Procesi i zhvillimit dhe vlerësimit të provimeve në programet e studimit zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, meritokracisë dhe paanësisë akademike. Organizimi i provimeve monitorohet nga pedagogë të caktuar nga Departamenti, me rregulla të qarta për pjesëmarrjen, sjelljen dhe përdorimin e pajisjeve elektronike. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të pavarur përmes sekretimit të tezave dhe respektohen afatet për dorëzimin e rezultateve.*<br>*Plagjiatura dhe kopjimi trajtohen si shkelje të rënda dhe ndëshkohen sipas Kodit të Etikës. Në rast të ankesave, studentëve u ofrohet një procedurë e strukturuar për rishqyrtimin e vlerësimeve, përmes komisioneve të paanshme, duke garantuar të drejtën e tyre për transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit. Këto mekanizma kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së procesit mësimor dhe të vlerësimit në institucion.*<br>*Institucioni ka vënë në dispozicion bazën rregullative por jo shembuj konkret nese ka pasur raste të praktikave të ndjekura për shqzrtim të ankimimeve nga studentët.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë | Në rregulloren e programit objektivi i programit të Studimit Master Shkencor në Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve ka të përcaktuar si objektiv kryesor ofrimin e njohurive dhe përgatitjen e specialistëve me formim të thelluar teorik dhe profesional, të aftë të mirë-orientohen në fushat e |

| | |
|---|---|
| profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | prodhimit të ushqimit, sistemeve të prodhimit, biodiversitetit, ekonomisë dhe politikave të tregut, të njohin aspektet ligjore dhe kuadrin rregullator të sektorit ushqimor. Në aspektin rregullator kjo është e saksionuar por në konstatimet e GVJ të mësipërme përsa i përket profileve të vecanta si Inxhinieri dhe cilësi ushqimore apo menaxheriale ku mos ofrimi në kurrikul i praktikave profesionale dhe gjithashtu mos përfshirja në kurrikul e lëndëve me karakter inxhinierik cënojnë arritjen e objektivit dhe misionit të programit të studimit.<br><br>***Evidencë 3: Plani Strategjik i zhvillimit 2022-2028.*** |
| **Kriteri 2**. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | GVJ vlerëson se programi i studimit siguron një bazë të mirë teorike dhe zhvillon aftësi të specializuara në fushën e sistemeve të menaxhimit të sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimeve, duke përfshirë njohuritë në menaxhimin e qëndrueshmërisë, sigurinë ushqimore dhe aspektet ligjore dhe ekonomike. Metodat mësimore që favorizojnë diskutimet dhe punën në grup janë pozitive për zhvillimin e kompetencave praktike. Megjithatë, mungesa e praktikave profesionale dhe e lëndëve me karakter inxhinierik, elementë kyç për një përgatitje të plotë të studentëve në këtë fushë si dhe regjistrimi i studentëve pa njohuri bazë në ekonomi, siç ndodh me ata që vijnë nga një program bachelor në bioteknologji, shkenca të ushqimit, shkenca të natyrës etj, paraqet një sfidë për arritjen e qëllimeve të programit dhe kërkon integrimin e moduleve ekonomike bazë për t'i mundësuar atyre të ndjekin me sukses kurrikulën.<br><br>*GVJ rekomandon shtimin e praktikave profesionale dhe modulëve inxhinierikë, si dhe ofrimin e kurseve bazë të ekonomisë për studentët me sfond jo-ekonomik. Gjithashtu, sugjeron zgjerimin e ofertës në gjuhën angleze për të rritur ndërkombëtarizimin dhe cilësinë e programit. Ky është dhe një objektiv i vëtë departamentit.* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të | Ekspertët vlerësojnë se programi i studimit ka një sistem të mirëstrukturuar për përcaktimin dhe vlerësimin e kompetencave dhe aftësive të fituara nga studentët, i cili pasqyrohet qartë në syllabus dhe është objekt diskutimi në nivel departamenti për përmirësime të vazhdueshme. Përfshirja e statistikave të rezultateve dhe analiza e tyre ndihmon në përshtatjen e qëllimeve mësimore me nevojat reale të studentëve. Tabela cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve që ndjekin programin. |

| | |
|---|---|
| rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Gjithashtu, organizimi i seancave konsultuese të fundit nëpërmjet të cilave studentët orientohen drejt përgatitjes së provimit përfundimtar është një praktikë efektive që rrit përqendrimin dhe suksesin në mësimnxënie. Kjo qasje mbështet fuqimisht orientimin profesional të studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës në nivele të ndryshme përgjegjësie. |
| **Kriteri 4**. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | GVJ vlerëson se mësimdhënia në program kombinon në mënyrë efektive njohuritë teorike me aftësitë praktike përmes detyrave kursi dhe punës në grup, duke promovuar diskutimin dhe zgjidhjen e rasteve studimore (UET, Strategjia e Kërkimit Shkencor 2021-2025). Personeli akademik tregohet i përkushtuar në krijimin e një mjedisi mbështetës për inovacion dhe kërkim shkencor, duke u angazhuar në projekte dhe publikime shkencore. Programi i studimit dhe kurrikula e ofruar në Departamentin e menaxhimit nuk ofrojnë praktika laboratorika dhe as praktik profesionale. Ky model mësimor përmbush kryesisht objektivat e zhvillimit të kompetencave të studentëve dhe aftësimin praktik të tyre. Modeli mësimor integron strategjitë institucionale për avancimin akademik dhe kërkimor. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Në përputhje me Kalendarin e Aktiviteteve të departamentit, lektorët e lëndëve programojnë zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve me të ftuar të ndryshëm nga bota e biznesit si dhe diskutimin e çështjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në fushën e studimit të cilës i përket lënda.<br>UET ka disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani si Balfin Sh.p.k. Lufra Sh.p.k, EHW Sh.p.k, të cilat bëjnë të mundur angazhimin e personelit të tyre në trajnime të zhvilluara përmes leksioneve të hapura dhe intershipete studenteve.<br><br>***Evidence 34.1-34.6. Memorandum bashkëpunimi*** |

| | |
|---|---|
| | ***Evidence 35; Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.*** |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Institucioni ka përcaktuar në "Strategjinë e Kërkimit Shkencor; Vizioni, pika 1.2, Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore[160]' me qëllim zhvillimin e ideve innovative dhe studime të avancuara për fusha specifike. Studentët janë përfshirë në konferencën shkencore ndërkombëtare që zhvillon UET, Ditët e Studimeve Shqiptare, dhe janë mbështetur financiarisht.<br>Në tabelat e plotësuara nuk evidentohet pjesmarrje e studentëve në projekte kërkimore të zhvilluara nga Departamenti përgjegjës për programin e studimit.<br><br>***Evidence 55.2 Kalendari i aktiviteteve te departamentit (Ref Nr.55.2)***<br><br>***Evidence34.34.1.34.6: Marrëveshja e Bashkëpunimit - Lista UET (Ref. Nr.34,34.1,34.6)***<br><br>***Evidence 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2020-2025.pdf***<br><br>***Evidence 55.1. Ditët e Studimeve Shqiptare Junior (DSSH)_2021-2024.pdf***<br><br>***Evidence 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf***<br><br>***Evidencë55.2. Kalendari i aktiviteteve 2022-2023.pdf*** |
| **Konkluzione** | *Ekspertët e jashtëm vlerësojnë se programi Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" ka një strukturë të mirëformuar akademike që synon formimin teorik dhe profesional të studentëve në fushat e prodhimit ushqimor, menaxhimit të qëndrueshmërisë, sigurisë ushqimore dhe aspekteve ligjore e ekonomike të sektorit, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2022–2028 dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021–2025.* |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">Mangësitë e evidentuara që cënojnë përmbushjen e plotë të standardit:<br>Mungojnë praktikat profesionale dhe modulet me karakter inxhinierik, të cilat janë thelbësore për realizimin e plotë të objektivit të programit.<br>Studentët e regjistruar nga fusha të tjera (p.sh., bioteknologji, shkenca të natyrës) shpesh nuk kanë njohuri bazë në ekonomi, çka përbën pengesë në ndjekjen me sukses të moduleve menaxheriale.<br>Nuk evidentohet pjesëmarrja e studentëve në projekte kërkimore të zhvilluara nga departamenti, megjithëse kjo është pjesë e misionit të institucionit.<br>Programi i studimit realizohet në drejtim të strukturës, objektivave dhe mësimdhënies me bazë kompetencash, por kërkon ndërhyrje për të siguruar plotësimin e misionit të tij dhe për të garantuar përgatitjen gjithëpërfshirëse të studentëve në të gjitha komponentët profesionalë dhe praktikë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi III.5<br>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</td><td>Institucioni harton procedurë të posaçme për mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit. Për t'u diplomuar studenti të mbrojë një punim diplome krijues dhe origjinal, i cili mund të jetë i karakterit teorik ose empirik që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit. Në rregulloren e programit kriteret për paraqitjen e diplomës bëhet sipas nje rregulloreje të vecante (Pika 7 e rregullores së programit). Nuk ka një Praktikë mbrojtje diplome dhe evidencë të diplomave të mbrojtura dhe temat, gjithashtu nuk qartësohet si ofrohet mbrojtja me komisione të përbashkëta të të dy institucioneve apo në komisione të ndara sipas profilit të temës së zhvilluar.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | ***Evidencë 7. Rregullorja e Programit të studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" pika 7.*** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Ekspertët vlerësojnë se procesi i mbrojtjes së diplomës në këtë program është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe transparente, në përputhje me standardet akademike dhe objektivat e ciklit të dytë të studimeve. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët në mënyrë të organizuar nëpërmjet seancave metodologjike, të cilat zhvillohen sipas një kalendari të miratuar dhe të publikuar më herët. Këto seanca ofrojnë mbështetje në aspektin metodologjik dhe teknik të përgatitjes së punimit të diplomës, duke ndihmuar studentët me informacione, materiale udhëzuese dhe orientim akademik.<br>Procesi është i rregulluar në dokumentin zyrtar "B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit", ku përshkruhen të gjitha hapat nga aplikimi dhe miratimi i temës, procedura e udhëzimit nga pedagogu përgjegjës, deri tek formatimi dhe mbrojtja para komisionit vlerësues. Ky dokument i vihet në dispozicion të studentëve përpara aplikimit për temën e diplomës, çka ndihmon në qartësimin e pritshmërive dhe detyrimeve.<br>Mbrojtja e punimit të diplomës është e detyrueshme dhe përfaqëson fazën përfundimtare të procesit të diplomimit. Ajo zhvillohet në mënyrë të formalizuar, përmes një prezantimi publik para komisionit të ngritur për këtë qëllim, duke u bazuar në vlerësimin e përmbajtjes shkencore, aftësive të analizës dhe përpunimit të informacionit, si dhe argumentimit profesional të studentit.<br>*GVJ vlerëson se procesi i diplomimit është i formalizuar dhe mirë i strukturuar, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për studentët dhe duke garantuar cilësinë dhe seriozitetin akademik të fazës përfundimtare të studimeve master. Ky proces kontribuon në përmbushjen e objektivave të programit dhe përgatitjen e studentëve për punë të pavarur kërkimore dhe profesionale.* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha | Bazuar në legjislacionin në fuqi në Programin e studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve", mbrojtja e Diplomës kryhet vetëm me Punim |

| | |
|---|---|
| lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Diplome. Nuk kryhet provim final për diplomim të studentëve që ndjekin këtë program studimi. |
| **Kriteri 4**. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Procesi i përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës në programin Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" është i rregulluar dhe mbështet studentin në mënyrë të strukturuar dhe metodologjike. Personeli akademik asiston në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temës së diplomës përmes seancave të organizuara metodologjike dhe tutoriatit akademik, sipas një kalendari të paracaktuar.<br>Departamenti siguron përputhshmërinë ndërmjet temës së propozuar dhe profilit të programit, duke miratuar udhëheqësin përkatës dhe duke ndërhyrë në rastet kur kjo përputhje mungon. Në mungesë të stafit të brendshëm të specializuar për tema të caktuara, parashikohet përfshirja e udhëheqësve të jashtëm brenda kritereve akademike të përcaktuara.<br>Në kuadër të udhëheqjes akademike, pedagogët trajtojnë të gjitha aspektet kyçe të punës kërkimore: formulimin e objektit dhe hipotezave të studimit, strukturimin e punimit, analizën e burimeve, si dhe përgatitjen përfundimtare për mbrojtje. Udhëheqësi garanton cilësinë akademike të diplomës përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe firmës përpara dorëzimit për mbrojtje.<br>*GVJ vlerëson se për mbrojtjen e temave të diplomës me karakter teorik dhe në fushën menaxheriale procesi i udhëzimit dhe mbrojtjes së diplomës është i mirëorganizuar, garanton cilësinë akademike të punimeve dhe kontribuon në formimin kërkimor të studentëve, në përputhje me objektivat e programit.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Nuk ka evidencë për temat e diplomës të cilat paraqesin një studim shkencor të bazuar në matje laboratorike dhe gjetje të vetë studetëve nga këto matje në ambjentet e Institucionit ( nuk ofrohen laboratorë shkencorë në testimet në produkte ushqimore).<br>Temat e studimit të profilit Inxhinieri, cilësi dhe siguri ushqimore nëse ka të përzgjedhura nga studentët nuk relizohen në UET. Nuk ka evidencë mbi temat e mbrojtura dhe pedagogët udhëheqës. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet për performancën e tij me pikë në bazë të një formati përkatës që përfshin vlerësimin me pikë të udhëheqësit të punimit të diplomës, oponentit dhe të çdo anëtari, pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Diplomave. Më pas bëhet mbledhja e pikëve totale të cilat përpjestohen me numrin e anëtarëve të komisionit, duke bërë të mundur në këtë mënyrë konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi.<br><br>***Evidence 10; Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, pika 13.4 - f dhe g*** |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Sipas dokumentit B.ll "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit", përcaktohet qartë se, në përfundim të studimeve, studenti pajiset brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, pasi Sekretaria Mësimore verifikon rezultatet e provimeve, të punimit të diplomës, dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara për përfundimin e programit të studimit. Njëkohësisht Sekretaria Mësimore harton dhe e pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Këto dokumenta firmosen nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me çertifikatën e notave. Çdo diplomë që lëshohet nga UET, regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.<br>Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Në raste të tilla studentët depozitojnë pranë sekretarisë mësimore një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit Master Profesional kundrejt pagesës përkatëse. Institucioni ka vënë në dispozicion Kopje të Diplomës dhe suplementit të diplomës (Model) . Programi i studimit është në proces akreditimi dhe nuk janë lëshuar Diploma për studentët që kanë mbaruar studimet.<br><br>***Evidence 10: Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit, pika 13.4 - f dhe g***<br>***Evidencë 15: model I diplomës***<br>***Evidencë 15.1: Suplementi I diplomës.*** |

<table>
<tr><td>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</td><td colspan="4">Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Zyra e kontratave dhe sekretaria në bazë të rregullores së arkivë-protokollit, dhe afateve të përcaktuara në të, ruajnë dhe arkivojnë dokumentacionin sipas kriterit.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ vlerëson se procesi i diplomimit në këtë program është i strukturuar dhe në përputhje me standardin, duke garantuar integritet akademik dhe mbështetje metodologjike për studentët. Megjithatë, rekomandohet përmirësimi i kapaciteteve laboratorike, për të mundësuar zhvillimin e punimeve eksperimentale të profilit inxhinierik në ambientet e institucionit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes sëstandardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi III.6<br>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</td><td>NA</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit</td><td>NA</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | | | | |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | **NA** | | | |
| **Konkluzione** | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore | Programi i studimit Master shkencor në "Sisteme të Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" i ofruar nga Departamenti Menxhimit dhe Marketingut për vitin akademik ka në përbërje të tij sipas raportimeve të vetë instiucioni 7 Personel efektiv dhe 9 personel me kontrate. Nga këto personel efektiv 1 mban titullin akademik Profesor, 1 Prof asociuar, 2 mbajnë gradën Dr dhe 3 Msc në proces doktorature. Stafi akademik në funksion të programit plotëson |

në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

kriterin për numrin minimal e stafit në një departament. Në procesin e mësimdhënies angazhohen staf akademik me sëpaku një gradë më lart se niveli i programit. Stafi akademik efektv në proces doktorature nuk angazhohet në Programin Master i Shkencave.

***Niveli i kualifikimit për stafin akademik që jep mësim në programin e studimit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" është si me poshtë:***

| Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit | **2022-2023** | | **2023-2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** |
| **Prof. Dr** | 3 | - | 4 | - | 5 | - |
| **Prof. As. Dr** | 1 | 1 | 5 | 3 | 5 | 3 |
| **Dr.** | 8 | 1 | 5 | - | 3 | - |
| **MSc (asistentë)** | - | - | - | - | - | - |
| **Total** | **12** | **2** | **14** | **3** | **13** | **3** |

Në modulet e lëndëve që ofron Departamenti i Menaximit dhe Marketingut në UET (48% e programit) angazhohen në mësimdhënie staf akademik me tituj dhe grada shkencore të profilit menaxherial dhe ekonomik.

GVJ konstaton se në raportimet e institucionit për ndarjen e lëndëve dhe ngarkesën e stafit ka mospërpuethshmëri në fushën e kualifikimit të lektorit dhe programit mësimor. Konkretisht Lënda Menaxhim total i cilësisë në industrinë agroushqimore për vitin akademik 2024-2025 mbulohet nga Prof.Asoc.Dr.S. J. Lektore eksperte në International trade /migration. Kjo lëndë për vetë specifikat e saj do të duhej të jepej nga staf akademik me të paktën kualifikime shtesë në inxhinieri ushqimore, bioteknologji, cilësi e ushqimeve, dietologji nutricion. Eksperiencë në Auditim i brendëshëm dhe i jashtëm të cilësisë në industrinë ushqimore. Lënda Etika e Ushqimit, Lektor K.M. i specializuar në shkenca

| | |
|---|---|
| | politike, marëdhënie ndërkombëtare, ndërkaq lënda do të kërkonte kualifikime shtesë për temat e etikës ushqimore, dhe përvojë në çështje të sigurisë ushqimore, legjislacionit ushqimor, ose filozofi morale dhe aplikative. Lënda Shkenca e Konsumatorit dhe Konsumim i qëndrueshëm, lektor A.M. master në shkencat agronomike dhe Dr. në fushën e pemëtarisë. Lënda do të kërkonte kualifikim shtesë në shkenca të ushqimit dhe sjellje të konsumatorit, marketing ushqimor dhe sjellje konsumatore, Shkenca të mjedisit. |
| **Kriteri 2**. Personeli akademik efektiv duhe të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me komizën ligjore në fuqi. | Personeli akdemik efektiv i të dy departamenteve ofrues të programit mbulon ngarkesën mësimore për programine studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.<br>Raporti orë staf efektiv / staf me kontrate 840 PAE/180 PAK, e shprehur në % ky raport është 82.4 % e ngarkeses totale mbulohet nga staf efektiv dhe 17.6% e ngarkeses mbulohet nga staf me kontrate. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Personeli akademik i institucionit është përgjithësisht i qëndrueshëm. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm pasi përzgjidhen me konkurs në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit dhe performancës të zbatueshme në UET, firmosin kontratë pune, fillimisht 1 vjeçare konform rregullave të punësimit përfshirë mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Kontrata nënshkruhet nga administratori dhe i punësuari, pasi kryhet dhe firmoset një deklaratë vlerësimi akademik nga dekani ose nga rektori në rastin e kontratës së dekanëve. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, punonjësit me grada shkencore mund të lidhin kontratë pune me afat ose pa afat. Ka një procedure punësimi, shpallje ne web e njoftimit, ngritje komisioni ad hoc i punësimit, vendimi i punësimit.<br>***Evidencë 11.1: Shembull thirrje për staf akademik.***<br>***Evidencë 11: Dokumenti Rregullore per burimet njerezore.*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, | Institucioni ka të sanksionuar në rregullore procedurën e punësimit të stafit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të drejtat dhe detyrat e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie.<br><br>***Evidencë 11: Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, pika G.1.6 fq. 2, G.1.7, G.1.8, G.1.9, G.1.10 fq.3***<br>***Evidencë 56: A.II. Kodi i Etikës (Ref. Nr. 56)*** |

| | |
|---|---|
| strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | ***Evidencë 11: Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, pika G.1.6 fq. 2, G.1.7, G.1.8, G.1.9 fq.3 (Ref. Nr. 11)***<br>***Evidencë 2: Statuti UET, Kreu V, Neni 44, pika 44.1, 44.2 44.3 fq. 27.***<br>***Evidencë 11: Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, pika G.1.6 fq. 2, G.1.7, G.1.8, G.1.9, G.1.10 fq.3*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Institucioni UET nuk ofron orë laboratorike si pjesë e programit mësimor. Departamenti përgjegjës për programin angazhon personel për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Institucioni disponon një strukturë të mirëorganizuar dhe funksionale për menaxhimin e personelit akademik, duke garantuar transparencë dhe përditësim të vazhdueshëm të të dhënave përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe drejtuesit të departamentit.<br>Zbatimi i procesit të dokumentimit dhe raportimit vjetor të CV-ve, publikimeve, ngarkesës mësimore dhe angazhimeve kërkimore siguron monitorim efektiv dhe shpërndarje optimale të burimeve njerëzore.<br>Standardi për menaxhimin e stafit akademik rezulton i përmbushur.<br>***Evidence 11: Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, pika G.1.6 fq. 2, G.1.7, G.1.8, G.1.9, G.1.10 fq.3***<br>***Evidencë 56 A.ll. Kodi i Etikës***<br>***Evidence 11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, pika G.1.6 fq. 2, G.1.7, G.1.8, G.1.9 fq.3)***<br>***Evidencë 2: Statuti UET, Kreu V, Neni 44, pika 44.1, 44.2 44.3 fq. 27.*** |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të | Institucioni ka hartuar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme në vend. Në programin mësimor nuk ofrohe praktikë profesionale në këto ndërmarrje. Temat e diplomës zhvillohen nen mbikqyrjen e pedagogeve. Udhëheqësit shkencorë mbikqyrin |

| | |
|---|---|
| arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | studentët në veprimtaritë specifike sipas profilit të përzgjedhur nga ata. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Në programin mësimor nuk eshtë parashikuar praktikë profesionale. Tema e diplomës ka 30 kredite ECTS NË TOTAL 360 orë nga të cilat vetë 24 orë zhvillohen në auditoret e institucionit. |
| **Konkluzione** | *Institucioni plotëson kërkesat ligjore për përbërjen e personelit akademik, duke angazhuar staf me grada dhe tituj përkatës, si dhe duke garantuar stabilitet dhe transparencë në administrimin e të dhënave të stafit.*<br>*Megjithatë, GVJ konstaton mospërputhje ndërmjet fushës së kualifikimit të disa lektorëve dhe natyrës së lëndëve që ata mbulojnë, çka cenon pjesërisht përmbushjen cilësore të standardit.*<br>*Nuk ofrohen orë laboratorike dhe nuk është planifikuar praktikë profesionale, ndonëse profili i programit kërkon komponentë të tillë, veçanërisht për lëndët me karakter inxhinierik dhe të cilësisë ushqimore.*<br>*Megjithatë, procedurat e punësimit janë të qarta dhe të dokumentuara, dhe institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit; duke kërkuar përmirësime në përputhjen e* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *profilit të lektorëve me lëndët dhe integrimin e praktikave profesionale.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Për vitin akademik 2024–2025, në programin Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" janë të regjistruar 18 studentë ne vitin e pare ne total ne te dy vitet jane 22 studente Raporti pedagogë/studentë rezulton brenda standardit të përcaktuar nga VKM Nr. 418, ndaj vlerësohet si i favorshëm për përkushtim individual dhe cilësi në mësimdhënie.<br>Procesi mësimor zhvillohet në formë interaktive në grupe, duke kombinuar shpjegimin teorik me diskutime dhe përfshirje aktive të studentëve.<br>Institucioni ka vënë në dispozicion mjedise të përshtatshme dhe të pajisura bashkëkohësisht për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve në selinë aktuale në Rr. Xhanfize Keko, si dhe më parë në Blv. Gjergj Fishta.<br>Standardi për numrin e studentëve, raportin pedagog/student dhe infrastrukturën mësimore vlerësohet i përmbushur.<br><br>***Evidence 27: Programit te Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"_Cilësia në hyrje dhe dalje, fq. 1***<br>***Evidencë 02: Tabelat.tabela 21.0*** |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit | UET disponon mjedise mësimore të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni për zhvillimin normal të procesit mësimor. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin dhe platformat online LMS. Pajisjet dhe infrastruktura në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit të mësimdhënies. |

| | |
|---|---|
| mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | ***Evidencë 42.1: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit*** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Në UET mjediset për zhvillimin e programit të studimit të selisë së vjetër dhe selisë aktuale të institucionit janë paisur me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave për zhvillimin e proçesit mësimor. Institucioni ka mundësuar paisjen e mjediseve me PC, mirëmbajtjen e tyre, instalim dhe azhornim të programeve në kohë reale nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.<br><br>***Evidencë 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit- Blv. "Gjergj Fishta", fq 1-3***<br>***Evidencë 42.1: Infrastruktura ne funksion te programeve te studimit Rr. "Xhanfize Keko", fq.1-2*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Institucioni garanton infrastrukturë të përshtatshme laboratorike për studentët e programit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". Në selinë e re të UET janë në funksion 7 laboratorë informatike të pajisur me PC, videoprojektorë dhe softuerë bashkëkohorë si Windows 10, Microsoft Office 365, MS Teams, Moodle (UET LMS), si dhe platforma dhe aplikacione të avancuara për analiza dhe modelim si Navicat, NetBeans, UCINET, JetBrain, CAD etj.<br>Gjithashtu, UET ka krijuar një Laborator Inovacioni (InnoLab) në kuadër të një projekti të financuar nga IADSA, i dedikuar për studentët dhe mbështetjen e aktiviteteve të lidhura me natyrën e programit të studimit.<br>Standardi i infrastrukturës mbështetëse për zhvillimin e procesit mësimor dhe digjital rezulton i përmbushur. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të | Institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera për zhvillimin e praktikës profesionale, gjithashtu ka hartuar dhe një rregullore të praktikës,por në programin mësimor nuk është parashikuar fond orësh i deyrueshëm për praktikë profesionale jashtë institucionit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni garanton raport të favorshëm pedagog/student (1:30), brenda normave të përcaktuara nga VKM nr. 418;*<br>*Mjedise mësimore të përshtatshme dhe bashkëkohore, të pajisura me PC, projektorë, sisteme audio, Wi-Fi dhe kondicionim në të gjitha ambientet; 7 laboratorë informatike dhe një Laborator Inovacioni (InnoLab) të pajisur me softuerë dhe platforma digjitale moderne për mësimdhënie dhe analizë. Mirëmbajtje dhe azhornim të vazhdueshëm të pajisjeve IT nga stafi teknik i institucionit.*<br>*Megjithëse institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe rregullore për praktikën profesionale, në programin mësimor nuk është i integruar një fond orësh i detyrueshëm për zhvillimin e praktikës profesionale. Kjo evidentohet si mangësi për programin, veçanërisht në profilin "Cilësi dhe Inxhinieri Ushqimore", për të cilin praktika do të konsiderohej komponent i rëndësishëm.*<br>*Përfundimisht, GVJ vlerëson se infrastruktura për mbështetjen e mësimdhënies, mësimnxënies dhe digjitalizimit është e mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat e standardit. Megjithatë, rekomandohet forcimi i komponentit praktik për të përmbushur më mirë objektivat e programit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Standardi IV.3**
**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Biblioteka e UET ofron një fond të mirë të literaturës, duke përfshirë libra dhe materiale akademike në gjuhën shqipe dhe të huaj, në format fizik dhe digjital. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka siguruar burime të përshtatshme për programin dhe lëndët përkatëse. Kjo ndihmon studentët dhe stafin akademik në përvetësimin e njohurive të kërkuara në program. Fondi i literaturës është në përputhje me nevojat e programit dhe është i aksesueshëm. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Departamenti ofrues i programit Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimeve" ka procese të rregullta komunikimi me përgjegjësin e bibliotekës për të siguruar përditësimin e fondit me literaturë të re, duke pasuruar fondin me botime bashkëkohore dhe relevante për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe kërkimor. Raportimi i përditësimeve dhe menaxhimi i numrit të kopjeve të materialeve të reja është i organizuar dhe i përputhshëm me kërkesat akademike dhe nevojat e studentëve. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka ofron ambiente fizike të përshtatshme për studim me një sallë biblioteke 40 m² dhe sallë leximi 50 m², duke siguruar 41 vende leximi. Bibliotekës ka pajisje kompjuterike për akses në burime online si SAGE dhe EBSCO, platforma të abonuar nga institucioni dhe të aksesueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët. Kjo siguron akses të mirë dhe të barabartë në burimet elektronike dhe të printuara për të gjithë studentët.<br><br>***Evidence 45.1; Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E IV.1, E.IV.2.1 E.IV.2.3 fq.1***<br>***Evidence 42.1: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr. "Xhanfize Keko", fq. 3***<br>***Evidence45.1; Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.3, fq.1***<br>***Evidence 4: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit- Blv. "Gjergj Fishta", fq. 2 (Ref. Nr. 42);*** |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën | Biblioteka e UET ofron një fond të mirëfilltë të literaturës fizike që përfshin tekste bazë dhe literaturë ndihmëse në shqip dhe gjuhë të huaja. |

| | |
|---|---|
| shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Fondi përmban libra dhe botime të përshtatshme për natyrën dhe specifikën e programit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve".<br>Përveç botimeve të jashtme, UET ka edhe botime të vetat (UET Press) dhe përkthime nga autorë shqiptarë, duke garantuar literaturë cilësore.<br>Biblioteka është pasuruar me artikuj dhe burime në anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht, duke përfshirë literaturë shumëspecializuar për fushën e programit.<br><br>***Evidencë 45: Inventari i teksteve në Bibliotekë në fushën e programit të studimit***<br>***Evidence 45; Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.8, fq.l 45*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe mjediset universitare kanë sinjal WiFi që siguron akses të lirë dhe falas në shërbimet e bibliotekës virtuale.<br>Institucioni ka abonime në disa platforma elektronike të njohura dhe të rëndësishme për fushën e studimit, si Sage, Ebsco, Questia, Edward Elgar Publishing, ASTM Compass dhe RESEARCH4LIFE.<br>Biblioteka ka krijuar katalogë me libra elektronikë në gjuhë të huaja, duke mundësuar akses të gjerë dhe të specializuar për studentët e programit.<br>Aksesi në bibliotekat online është i organizuar mirë dhe i lehtë për të gjithë studentët, duke garantuar barazi dhe mbështetje në kërkimin akademik. Kërkohet pasurimi i biblioteks me tituj të rinj në fushën e programit të studimit. Literaturë e 5 viteve të fundit. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Institucioni kujdeset vazhdimisht për sigurimin e një biblioteke me literaturë të pasur hardcopy, si dhe akses të katalogut online për libra elektronikë në gjuhë të ndryshme.<br>Në selinë e re të UET, biblioteka disponon numër adekuat kompjuterësh për përdorim të lirë nga studentët në shfrytëzimin e burimeve elektronike. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit | Orari i bibliotekës është i përshtatur me oraret e programeve të studimit, përfshirë programin "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". |

| | |
|---|---|
| mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka operon 6 ditë në javë, nga e Hëna në Premte me orar 9:00–20:00 dhe të Shtunën 10:00–17:00.<br>Gjatë periudhës së provimeve, raportohet që oraret zgjaten për të përmbushur nevojat e studentëve. |
| **Kriteri 8.**Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit raportojnë rregullisht për cilësinë dhe përditësimin e fondit fizik dhe atij online. Raportohet shkalla e shfrytëzimit të bibliotekës fizike, bibliotekës online dhe sallave të leximit nga studentët dhe stafi akademik. Evidentohet që bëhen përpjekje të vazhdueshme për pasurimin e fondit të bibliotekës, si fizik ashtu edhe elektronik. Gjithashtu, bëhen vlerësime mbi kërkesat për tituj të rinj dhe mbi performancën e personelit akademik në këtë drejtim.<br><br>***Evidencë 45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve".pdf***<br><br>***Evidence 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.pdf***<br><br>***Evidence 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e literatures ne biblioteke.pdf***<br><br>***Evidence 45.3. Shembull procedure_blerje literature.pdf*** |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në gjetjet e evidentuara, konstaton se institucioni përmbush në mënyrë të kënaqshme standardin për infrastrukturën bibliografike dhe shërbimet mbështetëse. Biblioteka ofron literaturë të mjaftueshme, fizike dhe digjitale, të përshtatshme për programin e studimit, dhe është e pajisur me teknologji të nevojshme për akses të lirë dhe pa kufizime nga studentët. Oraret e shërbimit janë të përshtatura me nevojat e studentëve dhe procesit mësimor, duke përfshirë edhe periudhat intensive si ato të provimeve. Njësitë përgjegjëse monitorojnë dhe raportojnë rregullisht përditësimin dhe përdorimin e burimeve, si dhe përpiqen për pasurimin e vazhdueshëm të fondit. Kështu, standardi vlerësohet i plotësuar me kushte të mira për mbështetjen e procesit mësimor.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Institucioni ka sistem të mirë të menaxhimit të të dhënave për studentët, duke përfshirë regjistrimin, ndjekjen e aktivitetit akademik, dhe procesin e diplomimit. Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Universitetit (UMIS) siguron përditësim, ruajtje me siguri dhe integritet të të dhënave. Gjithashtu, trajnimet për pedagogët lidhur me sistemin janë të detyrueshme dhe ndihmojnë në përmirësimin e procesit. Informimi i studentëve nëpërmjet UMIS dhe LMS është i mirëorganizuar.<br>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit të studentëve është funksional, i sigurt dhe i integruar me proceset akademike, duke plotësuar kërkesat e standardit. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Sistemi i menaxhimit mbulon jo vetëm studentët, por edhe personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, si dhe partnerët. Informacioni është i qasshëm në mënyrë të organizuar në databazën "Dokumenta UET", ndërsa në UET LMS ruhet dhe menaxhohet aktiviteti akademik, duke përfshirë materiale, detyra, dhe komunikimin me studentët.<br>Gvj konstaton që menaxhimi i informacionit për personelin dhe aktivitetin akademik realizohet në mënyrë efikase dhe transparente, duke mbështetur funksionimin optimal të programit. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi siguron akses të dedikuar për personelin akademik dhe studentët për informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe administrativ. Kjo i mundëson të gjithë palëve të kenë qasje të lehtë dhe në kohë reale për të dhënat e nevojshme.<br>Gvj konstaton që aksesi dhe transparenca në sistemin e menaxhimit janë të garantuara, duke mundësuar ndjekje të vazhdueshme dhe efektive të aktivitetit akademik dhe administrativ. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Institucioni ka integruar me sukses platforma për komunikim dhe mësim interaktiv si UET LMS dhe Microsoft Teams, të cilat shërbejnë për shpërndarjen e materialeve mësimore, komunikimin pedagog–student dhe për realizimin e mësimdhënies në distancë kur është e nevojshme. Studentët dhe stafi pajisen me kredenciale për akses dhe janë në dispozicion guida orientuese për përdorim. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi i menaxhimit mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik, përmes analizës së angazhimit të pedagogëve në platforma (UET LMS dhe Teams). Raportet për aktivitetin në platformë hartohen dhe dorëzohen periodikisht për autoritetet drejtuese. Këto mekanizma rrisin transparencën dhe mundësojnë ndërhyrje të shpejtë për përmirësim.<br><br>***Evidencë 46:Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf***<br><br>***Evidence 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf***<br><br>***Evidence 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun.pdf46.3. UET LMS Guide per studentet.pdf***<br><br>***Evidence 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf*** |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Institucioni ka një faqe zyrtare funksionale dhe dygjuhëshe (shqip dhe anglisht), ku publikon informacion të detajuar për të gjitha programet e studimit, përbërjen dhe kualifikimin e personelit akademik, aktivitetet kërkimore dhe shkencore, leksione nga të ftuar, projektet në zbatim, si dhe njoftime të tjera me interes për publikun dhe komunitetin akademik.<br>Ky nivel transparence dhe informimi publik vlerësohet në përputhje të plotë me kërkesat e standardit, duke përmbushur funksionin informues dhe garantues të aksesit të lirë në informacionin institucional.<br>***Evidencë 47.* Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës \\\v\\.uet.edu.al** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe të dhënat e verifikuara në faqen zyrtare të institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se standardi rezulton i përmbushur. Institucioni garanton transparencë përmes publikimit të rregullt dhe të përditësuar të të gjitha informacioneve për programet e studimit, strukturën dhe përbërjen e stafit akademik, aktivitetet kërkimore, projektet, bashkëpunimet dhe mundësitë për* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *studentët. Faqja zyrtare funksionon në dy gjuhë dhe siguron akses të lirë për publikun, duke përmbushur funksionin informues në përputhje me standardet e cilësisë në arsimin e lartë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion dhe të dhënat për mënyrën e menaxhimit financiar, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Institucioni siguron një menaxhim financiar të strukturuar dhe të kontrolluar, përmes hartimit të raporteve periodike mujore dhe vjetore, auditimeve të rregullta financiare dhe ndarjes së burimeve në funksion të kostove të programit. Buxhetimi mbështetet kryesisht në të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe në financimet nga projekte dhe grante të ndryshme. Përmes këtij sistemi, institucioni garanton vazhdimësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore, mbështetjen e studentëve dhe funksionimin cilësor të programit të studimit për një cikël të plotë. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra | Plani financiar i UET përfshin të gjitha kategoritë thelbësore të shpenzimeve: pagesa për personelin akademik dhe ndihmës, mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive, pasurimin e bibliotekës, aksesin në burime online, si dhe projektet/grantet e përfituara. Raportimi përfshin edhe analiza të krahasuara me vitet e mëparshme.<br><br>***Evidencë 50: Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | UET realizon auditim të brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë të rregullt çdo vit. Audituesi ligjor i jashtëm (E.E.I. shpk) jep opinion të pavarur mbi përputhshmërinë e pasqyrave financiare me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Auditimi përfshin analizën e pasqyrave të të ardhurave, shpenzimeve dhe rrjedhjes së parasë, duke garantuar transparencë financiare. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | UET raporton në fillim të çdo viti akademik realizimin financiar të vitit paraardhës, duke përfshirë të dhëna të detajuara për programet e studimit dhe njësitë bazë përkatëse. Raportimi ndaj njësisë përgjegjëse ndihmon në vlerësimin e përdorimit të burimeve financiare dhe përmirësimin e planifikimeve të mëtejshme |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të | Institucioni harton dhe miraton buxhetin vjetor me një plan të qartë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përfshirë edhe mekanizma për ndërhyrje të posaçme në rast nevoje. Strategjitë për diversifikimin e burimeve financiare, analiza periodike e eficencës dhe auditimet e rregullta kontribuojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare për programet e studimit. |

| | |
|---|---|
| këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | ***Evidencë 2: Statuti UET, Kreu VIII, Neni 54, pika 54.5, 54.6 fq. 31***<br>***Evidencë 50.4: Raport auditimi viti 2018***<br>***Evidence 50.5: Raport auditimi viti 2019***<br>***Evidence 50.6: Raport auditimi viti 2020***<br>***Evidence 50.1: Pasqyrat Financiare 2021;***<br>***Evidencë 50.2: Pasqyrat Financiare 2022.*** |
| **Konkluzione** | *Në përputhje me të gjitha kriteret e vlerësimit, GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë përmbush në mënyrë të plotë standardin për financimin dhe mbështetjen financiare të programit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", duke siguruar stabilitet ekonomik, transparencë dhe aftësi për të përballuar zhvillimet afatgjata të programit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me | UET është përgjegjës për përcaktimin e kritereve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe për këtë qëllim ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatorë per ciklin e studimeve universitare, Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve sic janë përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare Master i |

| | |
|---|---|
| legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve. Zbaton të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen bazuar në LAL nr. 80/2015.<br>Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, dhe ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | UET nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë.të studimit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve". Kjo vërtetohet nga rregullorja e Pergjitheshme dhe për Keshillin Studentor. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e integruar të ciklit të dytë në UET bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vit akademik. Kriteret e veçanta hartohen nga njësia bazë çdo fillim viti akademik. Emrat e kandidatëve fitues dërgohen në QSHA dhe MAS, si dhe publikohen në faqen e UET. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme dhe lehtesisht të kuptueshme pasi gjenden në faqen e web-it të UET, si dhe në Rregulloren e përgjithshme të UET. Politikat e pranimit të studentëve parashikohen edhe në programin e studimit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"", kritereve të pranimit, bursave që ofrohen tek faqja zyrtare web. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të | UET, çdo vit organizon takime me maturantët e shkollave të mesme, për ti informuar ata lidhur me programet e studimit, kriteret e hyrjes dhe tarifat e studimit. Në çdo fillim viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen e UET. Permes zhvillimit te aktiviteteve si Open Days |

| | |
|---|---|
| veçanta të programit të studimit. | maturanteve ju ofrohen vizita ne UET ku ata mund te njihen me programet specifike te studimit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Para fillimit të vitit akademik UET parashikon kritere dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të margjinarizuara pa kritere shtese për pranimin në programin e studimit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve".<br><br>***Evidencë 27.1: Dokumentin D.I Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.*** |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UET-i pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera, sipas procedurave të parashikuara me dokument të veçantë. Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse të programit të studimit sipas "Rregullore e UET, Neni 11 fq.4 Rregullore e Programit te Studimit te Ciklit të Dyte "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve".<br><br>***Evidence 7. Rregullore e programit te studimeve***<br>***Evidence 28: Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf*** |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Me disa kritere përzgjedhjeje, UET ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me prind me aftësi të kufizuara, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100%<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET, Neni 12 fq.4*** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *UET siguron nëpërmjet rregulloreve dhe akteve dhe evidencave se harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullative institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në web-in e UET. Gjithashtu, organizmi i keshillimit te karrierese informohen studentët apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse si dhe me kriteret e procedurat e perparimit akademik te studenteve dhe shtyrjes se studimeve ne nje vit tjeter akademik.<br><br>***Evidencë 5: Rregulloren e Programit te Studimit te Ciklit të Dyte "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" pika 2 fq.l, dhe pika 3.4, fq.4.*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara e të bëra publike. Po ashtu lejohen me rregulla të miratuara transferime të studenteve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera.<br><br>***Evidence 7: Rregullore e programit te studimit Programit te Studimit te Ciklit te Dyte "Master i Shkencave" ne "Sistemet e Qendrueshme te Prodhimit te Ushqimeve"***<br>***Evidencë 28: Dokumenti D.II. "Mbi transferimet, njohjen e*** |

| | |
|---|---|
| | ***krediteve dhe mobilitetin"***<br>***Evidencë 12; Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyres së Këshillimit të Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit.***<br>***Evidencë 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi, rregullore dhe mbarëvajtje provimi. Në rregulloren e programit të studimit shprehet qarte mënyra e vleresimit të dijeve në lëndët perkatese në përputhje me tipologjine e tyre. Po ky informacion përmbahet edhe tek syllabusi i lendeve.<br>Pra si konkluzion mund të parashtrojme se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studenteve në programin e studimit.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET***<br>***Evidencë19: Syllabuset e lendeve te ofruara ne Programit te Studimit te Ciklit të Dyte "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" .*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | IAL UET publikon informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj. UET për aplikimin për temë diplome, miratimin e temes dhe pedagogun udheheqes, deri tek faza e dorezimit dhe mbrojtjes se diplomes njoftohen ne villim viti sipas *Kalendari akademik 2022-2023* si dhe përmes e-mailave nëpërmjet koordinatorëve të Departamenteve.<br><br>***Evidencë 10: (Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit***<br>***Evidencë 7; Rregulloren mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dyte "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", pika 7 fq. 6***<br>***Evidencë 10.4: Kalendari akademik*** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon | Çdo fillim viti akademik UET harton kalendarin përkatës dhe organizon vizita nëpër shkollat e mesme me nxënësit maturantë për t`i njohur ata me programet e studimit që ofron IAL. Kalendari i përcillet për dijeni Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar. Zyra e Zhvillimit të Karrierës në UET organizon takime me maturantët për programet e studimit të |

<table>
<tr><td>takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</td><td colspan="4">UET-it, shpërndan postera, përgjigjet për pyetjet që kanë të interesuarit. Spoteve publicitare janë gjithashtu një praktikë që UETndjek.<br><br>Evidencë 51: Politika e marketing-ut të programit të studimit.pdf</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">UET vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| **Standardi V.3**<br>**Instituticioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" (Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"<br>Informimi ndodh gjatë gjithë procesit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"<br>Njoftimet gjenden në rubrikën e përcaktuar në web faqen e UET.<br><br>***Evidence 5. Rregullore e UET, Kreu 8, Neni 36-37, fq.10***<br>***Evidenca 12: (Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, Evidence***<br>***Evidence 46.3 (UET LMS Guide per studentet)*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, | Veç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndës. |

| | |
|---|---|
| përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Po ashtu qysh me heret punohet qe te njihen maturantet me programet e studimit qe ofron UET, kushtet dhe sherbimet per studentet, etj. "Open Days si dhe Java e Orientimit per studentet e rinj, kryhet ne baze te rregullores se UET. Tutoriati dhe keshillimi akademik sqarojne ceshtjet e frekuentimit dhe shlyerjen e detyrimeve .<br><br>***Evidencë 27.2 Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Studentët informohen për çdo aspekt për të cilin ata janë të interesuar, qofte në nivel fakulteti apo universiteti, si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. ZKK në bashkëpunim me ALUMNI-n hartojnë periodikisht raporte në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në UET. Rezulton që studentët e diplomuar në programin e studimit janë kryesisht të punësuar. Evidencë konkrete me shifra për punësim nuk ka. Ka vazhdimisht mentorim dhe networking (te gjitha burimet, partneritete te universitetit, panairet e punes, Alumni, Bordet e Tregut te punes; grupi i studenteve ne Linkedin, neteork i studenteve qe kane bere internship dhe Erasmus).<br><br>***Evidence 12. Dokumenti E -VII "Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit",***<br>***Evidence 02: Tabelat, tabela 23.*** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentet kane informacionin e duhur mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mesimor, logjistiken, infrastrukturen dhe Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve. Tregohet vemendje ne sherbimet ne funksion te realizimit te gjithe procesit te tij. Ata informohen mbi procesin mesimor nga sekretaria dhe kordinatoret, Zyra e Keshillimit te Karrieres, por edhe online nepermjet UET LMS, ku shkembejne informacion dhe materiale te ndryshme me Tutoriatit dhe keshillimin akademik. |
| | ***Evidencë27.2: Dokumenti A V: Mbi tutoriatin e keshillimit akademik. AV 1-2,*** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Per programin e studimi është ngritur dhe funksionon tutoriati ku për çdo kurs studimi është caktuar një pedagog i departamentit për t'i asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elemente të detajuar të programit të studimit qe gjendet edhe ne website te Fakultetit, si dhe LMS.<br><br>***Evidencë 27.2: Dokumenti A V: Mbi tutoriatin e keshillimit akademik. AV 1-2,***<br>***Evidencë 46.1: UET LMS Guide per studentet*** |
| **Konkluzione** | *UET siguron për studentët informacionin e nevojshëm në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit sikurse edhe nëpërmjet këshillimit të karrierës aftëson studentët me mundësitë në tregun e punës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | UET ka arkiva qe permbajne dokumentacion te plotë te dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre ne programin e studimit "Master i Shkencave" ne "Sistemet e Qendrueshme te Prodhimit te Ushqimeve, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit fakultet. Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e diplomave të lëshuara. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Sekretaret mbajnë regjistrin e regjistrimeve për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj.<br>*Gjatë vizitës në institucion u evidentuan disa mospërputhje/mangësi* si në vijim:<br>Regjistrimi i studentëve në regjistrin e diplomave nuk është bërë sipas datës së diplomimit dhe nuk janë plotësuar të gjitha të dhënat e numrave të diplomës.<br>Te gjitha problemet duhet *të shmangen duke verifikuar në mënyrë të vazhdueshme dokumentacionin dhe të sigurohet se po respektohen gjithë procedurat sipas ligjit në fuqi.* Konfuzioni i hasur në sekretari me plotësimin e regjistrave në mënyrë të saktë sipas dokumentacionit mbështetës dhe shtimi i stafit për atë zyrë e cila dokumenton materiale të konsiderueshme dhe voluminoze duhet konsideruar me përparësi. Vihen re edhe tërheqje nga programi, si dhe largime para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.<br><br>**Viti akademik** / **Të regjistruar**<br>2022-2023 / 21 studentë<br>2023-2024 / 4 studentë<br>2024-2025 / 18 studentë<br><br>***Evidencë 29: Të dhëna permbledhese për punesimin real të studenteve***<br>***Evidencë 27: Cilesia ne hyrje dhe dalje e Programit te Studimit te Ciklit te Dyte "Master i Shkencave" në "Sistemet e Qendrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"*** |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të gjitha të dhënat e studentëve administrohen nga sekretaria mësimore e UET. Autorizimi i të dhënave jepet nga titullari i institucionit, në përputhje me rregulloren perkatëse. Te dhenat statistikore te studenteve menaxhohen permes sistemit te brendshem te informacionit UMIS. Te specializuar ne keto ceshtje operojne persona te IT dhe sekretarise mesimore ndihmuar edhe nga sistemi UET-LMS. |

| | |
|---|---|
| | **Evidencë 46:** ***Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. Gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm *(Sistemi i Menaxhimit te Informacionit te Universitetit (UMIS)*. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme. Sipas deklaratave gjatë vizitës në institucion UET dhe Departamenti realizojnë kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga UET (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre.<br><br>***Evidencë 9: Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf***<br>***Evidencë 5: Rregullore e UET*** |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | GVJ konstaton se Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Karrierës harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportin vjetor që paraqitet.<br><br>***Evidencë 37: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf***<br>***Evidencë 29: Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre Tabela 23.pdf*** |
| **Konkluzione** | *UET mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. GVJ sugjeron që kontrolli i brendshëm i institucionit të jetë efektiv në shqyrtimin e dokumentacionit dhe shmangien e gabimeve qofshin ato njerëzore.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi. Këshilli studentor është organ kolegjial përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. *(Rregullorja e UET, perfshin studentet ne strukturat vendimmarrese.Po sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore te UETs*tudentet organizohen ne Keshill Studentor, ne fokus grupet e vleresimit te lendeve dhe pedagogeve. Studentet perfshihen gjithashtu edhe ne Senatin Akademik te UET, Dekanat, Keshillin e Etikes, dhe në Komisionin e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET, Kreu X, Neni 42, pika d, e,***<br>***Evidencë 47: Faqja zyrtare e Universitetit Europian te Tiranes www.uet.edu.al***<br>***Evidenccë 58: D.lll Mbi perfshirjen e studenteve ne qeverisjen e UET***<br>***Evidencë 30.4: Urdher administrativ mbi perberjen e KSBC*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin | Këshilli studentor është organ kolegjial përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Te gjitha te dhenat mbahen nga Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj |

| | |
|---|---|
| akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Studentit.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET, Neni 22*** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Ndër strukturat potenciale për përmirësimin e programit të studimit janë edhe *Studentët aktualë* në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit. Ata janë të organizuar me përfaqësuesit e tyre "senator" në nivel kursi por edhe në nivel programi studimi të cilët nëpërmjet Këshillit Studentor të Fakultetit perkates mund të përcjellin mendimet e tyre jo vetëm në Dekanat, por edhe në hallkën më të lartë të miratimit të planeve mësimore – Senatin Akademik – ku njëri prej anëtarëve është përfaqësues nga studentët. Përfaqësuesit e studentëve qe japin opinione edhe online ne cdo moment nepermjet UET LMS u pyeten nga GVJ në lidhje me mënyrën e perfaqësimit, ai siguroi se përcjell reagimet e studenteve për problematika të ndryshme nga kurrikulat e deri tek metoda e mësimdhënies dhe shperndarja e moduleve gjatë vitit akademik.<br><br>***Referencë 6: Dokumenti F. IV-F. V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit, F.V. pikat 4.2***<br>***Referencë 40: G-III-4-2 Formati i vleresimit te pedagogut nga studentet.*** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. UET ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit. Çdo provim parashikon edhe ditën e dhënies së rezultatit individualisht ku studenti ka të drejtën edhe të ankimimit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut te lendes. Provimet jane te sekretuara dhe garantohet anonimati me sekretim. Ka edhe seancat sqaruese ne te cilat studentet kuptojne dhe komunikojne me pedagogun perkates lidhur me vleresimin dhe mundesine per rishikim te veresimit. Në rast ankimimi, rivlerësimi bëhet përmes një komisioni AD -HOC që ngrihet në nivel departamenti/fakulteti.<br><br>***Evidencë 7: Rregullore e Programit te Studimit te Ciklit te Dyte "Master i Shkencave" ne "Sistemet e Qendrueshme te*** |

| | |
|---|---|
| | ***Prodhimit te Ushqimeve" Pika 5.8, faqe. 6***<br>***Evidencë 5; Rregullore UET, Neni 27, pika 27.8; Neni 28, pika 28.4, 28.5 fq.8***<br>***Evidencë 40.1; D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve***<br>***Evidencë 7: Rregullore e Programit te Studimit te Ciklit te Dyte "Master i Shkencave" ne "Sistemet e Qendrueshme te Prodhimit te Ushqimeve" Pika 5.8, faqe. 6*** |
| **Konkluzione** | *UET përfshin dhe angazhon studentët në vendimmarrje në lidhje me hartimin dhe mënyrën e zhvillimit të programit sikurse metodat e mësimdhënies dhe cilësinë e lekturimit dhe materialeve në dispozicion.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Zyra e karrierës ofron këshillim individual dhe grupal: përgatitjen për intervistat, hartimin e CV-së, dhe zhvillimin e aftësive të tyre të karrierës. Ndihma në gjetjen e punës dhe praktikave: Asistimi në kërkimin dhe aplikimin për praktika pune ose pozita të punës, duke ofruar burime për të gjetur mundësi të karrierës në fushën e tyre të interesit. Rrjetizimi: Inkurajimi i studentëve për të ndërtuar rrjetet e tyre profesionale duke lidhur studentët me profesionistë, alumni të universitetit dhe organizata që mund të ofrojnë mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht. Njësia e posacme që në UET është në funksion të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore te IAL-ve. Ka edhe dokumenta të tjera që mund të merren dhe gjenden në zyrën e sekretarise dhe koordinatoreve, në sisitemin UET LMS.<br><br>***Evidena nr.46.3 Guide per Studentet***<br>***Evidencë 47: Faqja zyrtare e institucionit.*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të | Zyra e Këshillimit të Karrierës përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundëshme në |

| | |
|---|---|
| posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. Pervec zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj, ka edhe zyra te projekteve dhe partneriteteve, Keshilluesit Akademik, sekretaria mesimore, kordinatoret e departamenteve, si dhe regjistruesit e lendeve, etj që gjithashtu mbështesin studentët.<br><br>***Evidencë 9: Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarise mesimore***<br>***Evidencë 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Këshillit të Karrieres dhe kujdesit ndaj studentit*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Zyra e këshillimit të karrierës në Fakultet është një strukturë ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me trajnimet, praktikat apo ofertat e punësimit. Kjo zyrë mirëpret, informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Nga ana tjetër kjo zyrë merr përsipër të njoftojë dhe ndjekë studentët në lidhje me aktivitete me karakter shkencor apo trajnimi për përditësimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektesh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. Sic e kemi permendur ne UET funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit e cila ofron ne menyre te vazhduar informacion dhe orientim te posagem, keshillim te karrieres, informacion ne lidhje me ecurine lidhur me kompletimin e procesit mesimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktiken profesionale në institucione të tjera, si edhe orientim në lidhje me tregun e punës.<br><br>***Evidencë 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik***<br>***Evidencë 12: Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit*** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e | Institucioni lehtëson në punësimin e studentëve të tij edhe brenda IAL, por edhe me punëdhënës të ndryshëm. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës.<br>UET ka marrëveshje të lidhura me farmaci private për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët dhe ofrimin e kontratave të punës pas diplomimit te tyre. Zyra mban rregullisht të dhëna rreth shkallës së punësimit të studentëve sipas degëve e viteve të tyre të diplomimit dhe gjatë intervistës |

| | |
|---|---|
| autoriteteve drejtuese përkatëse. | u pohua se shkalla e punësimit është e kënaqshme për studentët e diplomuar ne programin e studimit te ofruar në UET. Vec zyres së Karrierës një punë të rendësishme bën dhe zyra e Alumnit e cila ndjek studentet pas diplomimit dhe mban të dhena mbi punesimin e studenteve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studenteve, organeve dhe autoriteteve drejtuese perkatese, dhe në kuader të funksionit të saj<br><br>***Evidencë 12: (Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit***<br>***Evidencë 29: Tabele permbledhese per punesimin real te studenteve*** |
| **Konkluzione** | *Ndjekja e ecurisë, këshillimi në aftësimin e studentëve me njohuri për tregun e punës është i vazhdueshëm. UET krijon rrjetëzimin me ALUMNI dhe kompanitë potenciale për tregun e punës dhe mbledh këto të dhëna rregullisht.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të | UET ka hartuar disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, si manuali i zhvillimit të mësimit në distancë, apo udhëzuesin për punimin e diplomës. UET vendos prioritet trajnimin e personelit akademik per metodat e mesimdhenies. Vec kesa, realizon edhe angazhimin e personelit |

| | |
|---|---|
| fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | akademik ne pune te thelluar kerkimore dhe pedagogjike e cila do t'i mundësoje ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse.<br>Identifikimi i nevojave për kualifikime përditësuese në mësimdhenie aktualisht në institution realizohet nga sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore. Institucioni, gjithashtu ka krijuar një sistem të menaxhimit të performancës për personelin akademik sipas të cilit bëhet identifikimi i personelit akademik që përdor metoda klasike dhe që duhet të modernizoj mësimdhënien.<br><br>***Evidencë 41: G-I-12-1 Formular i vetevleresimit te performances se personelit akademik***<br>***Evidencë 30.9: Metodologjia e punes se KSBC Silabuset***<br>***Evidencë 37: Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve***<br>***Evidencë 30.10: Format Matrica e perputhshmerise se silabuseve***<br>***Evidencë 30.12: Shembull Relacion DMM Monitorimi i Silabuseve Semi 2021-2022***<br>***Evidencë 3.2(Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025***<br>***Evidencë 33: Të dhena per trajnime profesionale per stafin*** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | UET ka ngritur dhe ka funksional Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila synon të sigurojë përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme në nivel institucioni. NJSBC funksionon në bazë të rregullores së saj, dhe në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor të cilin ia paraqet rektorit, së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezualtatet e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Departamenti inkurajon kualifikimin e personelit akademik në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Kryhet identifikimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.<br><br>***Evidencë 2: Statuti UET, Kreu V, Neni 44, pika 3, fq.26*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e | UET garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime. Çdo vit nga NJSBC përfshihen |

| | |
|---|---|
| metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | nëpërmjet pyetsorit të gjithë studentët të cilët shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirë dhe vullnetare. Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies janë disa nene të rregullores se UET sipas një rendi hierarkik.<br>Për raportimin nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up), veprohet bazuar sipas rregulloes së miratuar. Studenteve u krijohet mundësia për vleresimin periodik të cilesise së mësimdhënies, ankimimin, sqarimin etj.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore UET, Neni 22, pika 2, fq.6***<br>***Evidencë 30.8; G-III-4-1 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu***<br>***Evidencë 30.13: (Metodologjia e punes se KSBC_ Fokus Grup***<br>***Evidencë 30.14: Shembull_Njoftime dhe komunikime per zhvillimin e fokus grupeve***<br>***Evidencë 30.15: Shperndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve***<br>***Evidencë 40: G-III-4-2 Formati i vleresimit te pedagogut nga studentet***<br>***Evidencë 41: G-I-12-1 Formular i vetevleresimit te performances se person el it akademik***<br>***Evidencë 30.9.: Metodologjia e punes se KSBC Silabuset; Evidencë: Forrnal_Matrica e perputhshmerise se silabuseve (Ref. Nr.30.10);***<br>***Evidencë 30.11Shembull Komunikime dhe shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset***<br>***Evidencë 40: G-I1I-4-2 Formati i vleresimit te pedagogut nga studentet Evidencë 40.1: D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve***<br>***Evidencë 5: Rreguliore UET, Neni 27, pika 27.9, fq.8***<br>***Evidencë 5: Rreguliore UET, Neni 32, fq.9 (Ref.Nr.5)*** |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm në faqen web të UET. Rezultatet e vleresimit të përftuara nga raportimi, bëhen publike<br>Një nga format e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhenies dhe dijeve është nëpërmjet vleresimit të pedagogut nga student sipas dokumentit<br>Rezultatet e vleresimit, pasi përpunohen nga KSBC mbështetur në dokumentin apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen drejtuesave të UET. |

| | |
|---|---|
| | ***Evidencë 2: Statuti UET, Kreu 1, Neni 11, pika 3, fq.5***<br>***Evidencë 40: G-11J-4-2 Formati i vleresimit te pedagogut nga studentet***<br>***Evidencë 81: Dokumenti F.VJI Mbi Sigurimin e Brendshem të Cilësisë.*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Institucioni UET, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet diskutohen dhe shoqërohen me komente dhe mënyra që cojne në adresimin dhe përmiresimim e mangesive të gjetura. Vleresimi me rezultatet e mara nga UET, propagandon praktikat më të mira, shembull për personelin akademik.<br><br>***Evidencë 5: Rregullore e UET, Kreu V, Neni 45, pika 5*** |
| **Konkluzione** | *UET garanton cilësinë e mësimëdhënies nëpërmjet mekanizmave të ngritura, NJSBC, e cila monitoron dhe raporton gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. UET ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të mësimdhënies.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë IAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), uet implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e tij përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, në përputhje me standardet shtetërorë të cilësisë dhe kodin e cilësisë. Në planin |

| | |
|---|---|
| | strategjik të UET, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, një vëmendje e vecante i kushtohet sigurimit të cilësisë si një kërkese themelore për rritjen e reputacionit të UET kudo Për sigurimin e cilësise UET, aplikon Standardet për Sigurimin e Cilësise në Hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë, të orientuara në Strategjitë, politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, aprovimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve të studimit, vlerësimi i studentëve, sigurimi i cilësise së stafit akademik, burimet e të nxënit dhe përkrahja e studentëve, sistemet informative, etj.<br>ZSC funksionon në baze të gjithë veprimtarise së institucionit. Zyra e Standarteve dhe Cilësisë (ZSC), mban përgjegjësi të plotë sipas dokumentave të miratuar. Gjithashtu Zyra e Kurrikulave si fakulteti dhe universitet funksionojne aktivisht përmes Komisioneve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<br><br>***Evidencë 3: Plani Stralegjik 2015-2020.***<br>***Evidencë 3.3: Plani Slrategjik 2021-2025***<br>***Evidencë 5: Rregullore e UET, Kreu V, Neni 45, pika 5***<br>***Evidencë 53: Ligji 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne JAL ne RSH", kreut X-Sigurimi i Cilesise ne Arsimin e Larte, neni 103-Siguiimi i brendshem i cilesise.***<br>***Evidencë 53.2: VKM Nr.531, date 11.06.2018 "Per miratimin e Kodit te Cilesise ne Arsimin e Larte"***<br>***Evidencë 30.2: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësise,*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore.<br>Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës, plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimit, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në përfundim të këtij procesi është |

| | |
|---|---|
| | hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit.<br>Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel Departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë.<br>Në këto cështje përfshihen edhe studentët.<br><br>***Evidencë 30.3: Strategjia për sigurimin e brëndshëm të cilësise 2017-2022, IV. Organizimi dhe Operimi i Sistemit për Sigurimin e Brendshem të Cilësise,***<br>***Eviencë 30.3.1; Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, Kreu III, pika 3.1. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL.<br>KUR, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes, dhe cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si, sondazhe e intervista të studentëve. Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të anketuarit përpunohen nga NJSBC dhe i paraqiten autoriteteve drejtuese në IAL për njohje dhe vlerësim. Sigurimi i Jashtem i Cilesise ne arsimin e larte ne UET realizohet kryesisht nga vleresimi i jashtem i akreditimit, (raportet e RVJ prane KSBC). Me rendesi eshte fakti qe nga nje axhenci e huaj (Britanike) UET ka mare vleresim pozitiv per akreditiinin institucional nga (AAQ) me nje afat prej 5 vite. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime | Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron UMT, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC. UET permes zbatimit te dokumentiacionit dhe udhezimeve kryen monitorimin, vleresimin per cdo process akademik dhe raporton ne manure prioritare e hierarkike<br><br>*Nuk ka evidence të konkluzioneve të monitorimit të syllabuseve për këtë program studimi dhe evidentimit të* |

| | |
|---|---|
| nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | *mospërputhshmërisë së tyre me vkm nr 41/2018 për elementët e programit të studimit master shkencor në akreditim.*<br><br>***Evidenca 30.12 Shembull_Relacion DMM Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022***<br><br>***Evidence 37: Formati i relacionit monitorimin e silabuseve***<br><br>***Evidencë 30.9: Metodologjia e punes së KSBC Silabuset***<br><br>***Evidencë 30.10;30.11 Format Matrica e përputhshmërise së silabuseve***<br><br>***ShembullKomunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset***<br><br>***Evidencë 30.12: Shembull Relacion DMM_Monitorimi i SilabuseveSem 1 2021-2022*** |
| **Konkluzione** | *UET harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit falë strukturave të brendshme si NJSBC, departament dhe mekanizmave të matjes së performancës, anketime dhe raportet vjetore të mësim-kërkimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, | UET përdor mekanizma dhe procese formale për shyqrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në Departamente dhe nivel Fakulteti, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit.<br>Në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre.<br>Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, |

| | |
|---|---|
| motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim.<br><br>***Evidencë 30.5: Metodologjia e punes se KSBC provimet (Ref.***<br>***Evidencë 30.6: Format raporti per kontrollin e provimeve (Ref.***<br>***Evidencë 30.7: ShembullKomunikime dhe shperndarja e raportit te KSBC mbi provimet***<br>***Evidencë 30.8: Shembull Raporti per provimet Sem 1 v.a.21-22 - DMM FEBZH*** |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik, Drejtoria e Kurrikulave nis procesin e përditësimit të programeve në nivel institucional me qëllim rritjen e cilësisë në përmbajtje të tyre. Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegjiale të UET (Senat Akademik dhe Bordi i Administrimit), ku evidentohet qartë plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit.<br>Nga kontrolli për zhvillimin e provimeve sipas (Format Raporti për Provimet, vihet në dukje me gjetjet përkatëse përmes një metodologjie që përmbahet në dokumentin *(Metodologjia e punës së KSBC Provimet)*.<br><br>**Evidencë 30.5: Metodologjia e punes së KSBC provimet**<br>**Evidencë 30.6: Format raporti per kontrollin e provimeve**<br>**Evidencë 30.7: Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit te KSBC mbi provimet**<br>**Evidence 30.8: Shembul l_Raporti per provimet Sem l_v.a.21-22 - DMM FEBZH** |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, | UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Metodat e përdorura në UET për vlerësimin e cilësise së programit të studimit, kryhen në bazë të dokumentit *Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e* |

| | |
|---|---|
| vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | *objektivave formuese (Ref. Nr. 38); Procedure për ndryshimin e kurrikulës (Ref. Nr.52).*<br>Departamenti, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor mënyra të tjera vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (ALUMNI), të personelit akademik, ndihmës-akademik, drejtuesit e farmacive që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. Në baze të këtij aktivitetit të UET qëndrojne këto materiale të miratuara që rregullojne jetën e brendëshme.<br><br>***Evidence 30.8: G-III-4-1 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu,***<br>***Evidencë 30.17: Fisha e projektit Enchase,***<br>***Evidencë 30.18: Fisha e projektit QAinAL,***<br>***Evidencë 30.19: Fisha e projektit; Bologna Hub Peer Support***<br>***Evidencë 30.1: Plani i veprimit KSBC, fq. 4-6***<br>***Evidence 29: Tabelat permbledhese per punesimin real te studenteve***<br>***Evidence 34: UET Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (Ref. Evidence 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale***<br>***Evidencë 34.1 (Aneks Tabela 5); Marreveshje Bashkëpunimi UET dhe The PIaza Tirana Memorandum Bashkëpunimi mes UET dhe E.H. E (Ref Air).*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në | UET merr pjesë gjithashtu në zhvillimin e sondazheve në nivel kombëtar, që zhvillohen nga ASCAL. Për këtë qëllim IAL ngre grup pune, i cili asiston studentët në orientimin e procesit të sondazheve, si dhe u krijon mundësi që në anonimanitet të plotë të plotësojnë pyetësorët. Vec metodave direkte përdoren edhe mekanizma të tjere për ecunine e cilësise se programit te studimit.<br>Për këtë ndihmojne edhe pyetësorët online në UET LMS, fokus grupet, mbledhjet e bordit të punës me të diplomuar (alumni) të cilët synojne perfshirjen e ish-studenteve ne aktivitete dhe shkëmbimin e eksperiencave në UET. Një vlere e shutuar është edhe Panairi i Përvitshëm i Punës, ku ne ishim present në ditët e takimeve në UET, si dhe mekanizma të tjere që ndihmojne mbarëvajtjen e programit në tëresi mbështetur në |

| | |
|---|---|
| realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | dokumentacionin përkatës.<br><br>***Evidencë 30.3.1: (Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise 2017-2022, Kreu IV, 4.11, fq.7-8***<br>***Evidence 30.3: Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise 2023-2028, Kreu IV Fusha dhe qasje te vlervsimit ne kuader te sigurimit te cilesise, pika 4.1 Cilesia e Programeve te Studimit dhe Mesimdhenia***<br>***Evidencë 12.2: Poster Panairi i Punës 2018, 2019, 2021*** |
| **Konkluzione** | *UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve me qëllim garantimin e objektivave formuese dhe rezultateve të kënaqshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | UET nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC. Cështjet e sigurimit të cilësise së brendshme janë të mbështetura në statutin e institucionit, rregulloren, strategjinë e sigurimit të Brendshëm të Cilësise, udhëzimet e standardeve europiane dhe standardet kombëtare për sigurimin e cilësise. *Manuali për sigurimin e brëndshëm të cilësisë, Sesioni 2, pika 2.1, fq.8*<br>Studentët marrin pjese në vlerësimin edhe përmes pyetësorëve, fokus grupeve, etj.<br><br>**Evidence 30.2: Manuali për sigurimin e brëndshëm të cilësisë, Sesioni 2, pika 2.1, fq.8 (Ref. Nr.30.2). Questionnaire fq. 30-31 Evidence 30.3.1: Strategjia për sigurimin e** |

| | |
|---|---|
| | **brendshem te cilesise 2017-2022, Kreu IV, pika 4.7.1, pika 4.7.2, fq.7;**<br>**Evidencë 30.3: Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise 2023-2028, Kreu II Politika për Sigurimin e Cilesise, pika 2.1. Objektivat Strategjike, pika 2.2. Parimet e Menaxhimit të Cilesise, pika 2.3. Standardet e Sigurimit te Cilesise** |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Detyrat konkrete të NJSBC parashikohen në nenet e rregullores së NJSBC. Vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik bazohet në kriteret e mëposhtme:<br>▪ Vlerësim nga njësia kryesore mbi bazën e raportit të hartuar nga njësia bazë në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen.<br>Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit – çdo fund viti drejtuesi i departamentit, harton një raport përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimit përmes raportit semestral të hartuar nga pedagogët.<br>Praktikat dhe metodologjine e sigurimit te brendshem te cilesise ne saje te pjesemarrjes ne trajnime, vizita studimore, workshope te organizuara ne kuader te projekteve nderkombetare per te garantuar ushtrimin me pergjegjesi te ketyre detyrave.<br>Në funksion të kësaj kryhen edhe trajnime.<br>Rregullisht kryhet monitorimit i aktiviteteve lidhur me zbatimin dhe vlerësimin e syllabuseve, plotësimin e planit mësimor, planit të punës kërkimore etj.<br><br>***Evidence; Nr.30.3.1; Strategjia për sigurimin e brëndshëm të cilësisë 2017-2022. Kreu IV, pika 4.7.1 pika 4.72, fq/7***<br>***Evidence 30.2; Manuali per sigurimin e brendshem te cilesise, Sesioni 2, pika 4.3, fq.l 7***<br>***Evidencë 19.1: Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) (Ref. Nr. 19.1); Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve"*** |

| | |
|---|---|
| | ***Evidence 14.2: Plani mësimor i programit shqip***<br>***Evidencë 14.1: Plani mësimor i ndare sipas vepimtarive formuese***<br>***Evidence 30.3: Strategjia për sigurimin e brëndshëm të cilësisë 2017-2022, Kreu V, pika 5, fq.10 (Ref. Nr.30.3.1); Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, Kreu IV Fusha dhe Qasje të Vlerësimit në Kuader të Sigurimit të Cilësisë, pika 4.1. Cilësia e Programeve të Studimit dhe Mësimdhënia*** |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjial dhe miratohet me vendim të SA. Gjithashtu, sigurimi i cilësisë në UET inicion në nivel Njësie Bazë me ngritjen e grupeve ad-hoc të cilët merren me çështje si, rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programit të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor e kërkimor shkencor. Në grup futen dhe përfaqesues i studentëve të cilët janë në vitin e fundit të studimit.<br>Departamenti dhe personeli akademik i programit të studimit Master Shkencor në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve" kryen aksion vlerësimi periodikisht sipas rregulloreve në fuqi.<br><br>***Evidence 2: Statuti I UET***<br>***Evidence 30.1: Planit veprimit KSBC, fq. 1-6*** |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlerësimi i studentët dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë.<br>Në përzgjedhjen e anëtarëve në proceset ciklike të vlerësimit janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperienca të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese.<br>Rëndësi i kushtohet njohjes dhe zbatimit të Kodit të etikes *pa* diskriminim apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.<br><br>***Evidencë 56: Kodi i etikës.*** |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të | NJSBC në përbërje të saj ka një ekspert të jashtëm, i cili jep kontribut në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e raporteve të kësaj strukture. Kjo është e parashikuar edhe në statutin e IAL. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Aktivitetet si Panairi i punës, shoqërohen me leksione të hapura nga të huaj jashtë UET partnere dhe donator.<br>***Evidencë 34: UET Lista e marrëveshjeve te bashkepunimit***<br>***Evidencë 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5);***<br>***Evidencë 34.134-6: Marrëveshje Bashkëpunimi***<br>***Evidence 32.1: Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale pika B. I, fq 1***<br>***Evidencë 12.2: Poster Panairi i Punës 2018, 2019, 2021,2022*** | | | |
| **Konkluzione** | *IAL garanton përfshirjen e palevë të interesit, stafit dhe studentëve në vlerësimin e cilësisë, informon për rezultatet dhe masat e marra për këtë aspekt.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike në faqen zyrtare të UET, fton studentët dhe stafin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. *Rregullat dhe udhëzimet në UET kërkojne publikimin e veprimtarive përfshire dhe ato për Sigurimin e Brëndshem të Cilesise në nivel universiteti, në faqen zyrtare të UET.* Vazhdimisht tregohet kujdes për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale.<br><br>***E*****vidence 47: Faqja zyrtare e Universitetit Europian te Tiranes, Raporte Vleresimi, https://uet.edu,al/rrctli-uct/, Evidence 56 (A.II. Kodi i Etikes, pika A.II.7/7 fq,3 (Ref. Nr.56)** |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të | UET në përfundim të çdo viti akademik publikon raportin vjetor të cilësisë, i cili hartohet nga struktura e NJSBC brenda |

| | |
|---|---|
| programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | institucionit. Ky raport përfshihet edhe në raportin vjetor të aktiviteteve të IAL<br>Liria dhe etika akademike, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurohen përmes zbatimit të rregullores përkatëse. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse.<br>Nëse këto gjetje kanë impakt në organizimin e institucionit dhe prekin aspekte të rëndësishme të funksionimit të tij, ato diskutohen në Senatin Akademik. Në rastet kur gjetjet kanë impakt financiar ato adresohen për vlerësim dhe vendimmarrje në Bordin e Administrimit. Për plotesimi të mangësive të vërejtura, zhvillohen mbledhjet e departamentit me personelin akademik dhe ndërhyhet në përputhje me gjetjet dhe nevojat.<br>Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna.<br><br>***Evidencë 30.3.1 Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise 2017-2022, Kreu III, pika 3.3,***<br>***Evidencë 30.3 Strategj ia persigurimin e brendshem te cilesise 2023-2028: Veprimtari Monitorimi, Vleresimi dhe Permiresimi*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe studentët. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.<br>UET është i vëmëndshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit MSH në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", syllabuset dhe kurrikulat.<br><br>***Evidenca 47: Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës, Raporte Vlerësimi, https://uet.edu.af rrcth-uet*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin | Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Asambleja e pedagogeve, organizon trajnime të ndryshme dhe i publikon në faqen zyrtare dhe UET LMS, për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. | | | |
| **Konkluzione** | *Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve", me profile "Inxhinieri, Cilësi dhe Siguri Ushqimore" dhe "Menaxhim i Sistemeve të Prodhimit të Ushqimeve" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Europian i Tiranës.</u>**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Program i përbashkët ndërmjet dy universiteteve me reputacion si Universiteti Europian dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës (UET dhe UBT).
2. Kurrikula është në përputhje me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare (SDG, Green Deal, Farm to Fork).
3. Ofrohet diplomë e dyfishtë, duke rritur vlefshmërinë ndërkombëtare të diplomës.
4. Staf i kualifikuar me tituj shkencorë dhe përvojë në fushën e Menaxhimit.
5. Fokus i qartë në qëndrueshmëri, menaxhim i sistemeve të qëndrueshme dhe siguri ushqimore.
6. Marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani prodhuese dhe agrobiznesi.

**Pikat e Dobëta:**

1. Komponentët e planit mësimor përgjegjës për secilën njësi nuk janë paraqitur qartësisht. Mospërputhje në ndarjen e moduleve midis dy institucioneve. [(Fusha II. /Standarti II.1); (Fusha I. / Standarti 1,2. /Kriteri 3)]

2. Në planin mësimor nuk janë paraqitur ndarjet në orë leksioni/laboratori sipas modelit të Tabelës. 10. [(Standarti II.2/ Kriteri 1, Kriteri2)]

3. Nuk është respektuar Udhëzimi i VKM Nr. 41/2018. Për elementët e programit të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë. Konkretisht, ndarja e krediteve ECTS sipas kategorive për programet master Shkencor. [(Standarti II.1/Kriteri 2, kriteri 3)]

4. Mungesë e praktikës profesionale në kurrikulë, në kundërshtim me VKM Nr. 41/2018. [(Standartit III.6. Kriteri1. Kriteri 2. Kriteri 3. Fusha III)]

5. Gvj konstaton që nuk është plotësuar rekomandimi i dhënë në urdhërin e hapjes së Programit nga MASR. [ (Fusha II, Standardi II.1 / Kriteri 1)]

6. Mungesë transparence në komponentin laboratorik për lëndët teknike/inxhinierike. [(Fusha III/ Standardi III.4/ Kriteri 2)]

**Rekomandime:**

1) Rishikim i Kurrikulës bazuar në ndarjen e lëndëve sipas kategorive dhe udhëzimeve në VKMNr.41/2018, për programet e ciklit të dytë master Shkencor.
2) Plotësim i rekomandimeve të lëna nga grupi i vlerësuesve në urdhërin e hapjes së Programit të studimit UMAS nr. 575, date 04.10.2022 . Sipas ketij urdheri, UBT dhe UET duhet te permbushin rekomandimet e eksperteve te jashtem, ne lidhje me saktesimin ne planin mesimor dhe në syllabuse, të ngarkesës mësimore në orë, për laboratorët në lëndët ku parashikohet (pika 3).
3) Forcimi i komponentit praktik dhe rritja e bashkëpunimit me industrinë ushqimore për të përgatitur studentët për tregun e punës.
4) Rishikimi i kurseve/lëndëve që lidhen me profilin inxhinieri dhe cilësi e ushqimeve për të përmbushur objektivat e programit, përputhjen me emërtimin e diplomës dhe formimit të marrë si dhe për të përmirësuar ekuilibrin midis njohurive teorike dhe zbatimit praktik.
5) Rritja e përfshirjes së stafit dhe studentëve në projekte kërkimore dhe partneritete ndërkombëtare në fushën e studimittë programit.

6) Zhvillimi i kurseve të shkurtra ose programeve të certifikimit për të përmirësuar punësimin e studentëve.

7) Sigurimi i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të programit përmes reagimeve nga studentët dhe palët e interesuara të tregut.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Sustainable Food Production Systems", with profiles "Food Engineering, Quality and Safety" and "Food Production Systems Management" provided by the Higher Education Institution "UET."**

**Strengths:**

1. Joint program between two reputable universities (UET & UBT).
2. Curriculum aligned with national and EU strategies (SDGs, Green Deal, Farm to Fork).
3. Offers a dual degree, enhancing international recognition.
4. Qualified academic staff with scientific titles and field expertise.
5. Clear focus on sustainability, food safety, and modern technologies.
6. Extensive partnerships with aggro-food companies and institutions.

**Weaknesses:**

1. The components of the curriculum responsible for each unit are not clearly presented. Field 1. Standard 1,2. Criterion 3. Inconsistency in the division of modules between the two institutions. [(Field II/ Standard II.1;) (Field I, Standard 1,2/ Criteri 3].
2. The division into lecture/laboratory hours according to the model of the Table is not presented in the curriculum. 10. [(Standard II.2. Criterion 1, Criterion 2)].
3. The Instruction of the Council of Ministers No. 41/2018 has not been respected. On the elements of the studyprogram in Higher Education Institutions. Specifically, the division of ECTS credits by categories for Master's programs in Science. [(Standard II.1. Criterion 2, Criterion 3)]
4. Lack of professional practice in the curriculum, in violation of the Council of Ministers' Decision No. 41/2018. [(Standard III.6. Criterion 1. Criterion 2. Criterion 3. Area III)]
5. The Court finds that the recommendation given in the order opening the Program by the Ministry of Agriculture and Rural Development has not been fulfilled. [ (Area II, Standard II.1 / Criterion 1)]

6. Lack of transparency in the laboratory component for technical/engineering subjects. [(Area III/ Standard III.4/ Criterion 2)]

**Recommendation:**

1) Curriculum review based on the division of subjects according to categories and instructions in VKM Nr.41/2018, for the second cycle Master of Science programs.
2) Completion of the recommendations left by the group of evaluators in the order for the opening of the study program UMAS no. 575, date 04.10.2022. According to this order, UBT and UET must fulfill the recommendations of external experts, regarding the specification in the curriculum and syllabus, of the teaching load in hours, for laboratories in the subjects where it is foreseen (point 3).
3) Strengthening the practical component and increasing cooperation with the food industry to prepare students for the labor market.
4) Review of courses related to engineering to improve the balance between theoretical knowledge and practical application.
5) Increasing the involvement of staff and students in research projects and international partnerships in the field of study of the program.
6) Developing short courses or certification programs to improve student employ-ability.
7) Ensuring ongoing monitoring and evaluation of the program through feedback from students and market stakeholders.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | X | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT** | | | X | |
| **IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT** | | | | X |
| **V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE** | | | | X |
| **VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT** | | | | X |
| **VLERËSIMI TËRËSOR** | | | X | |